



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
Kuvendi i Komunës



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

PROCESVERBALI

Nga mbledhja II / 2025 e rregullt e Kuvendit të Komunës, mbajtur më 27 mars 2025, filluar nga ora 10:00, në Kuvendin e Komunës së Prizrenit.

Në fillim të mbledhjes ishin të pranishëm 28 anëtarë të Kuvendit të Komunës, u bashkëngjitën edhe anëtarë të tjerë gjatë zhvillimit të mbledhjes.

Të pranishëm në mbledhje ishin: Kryetari, Nënkryetari dhe Drejtorët Komunal.

Po ashtu të pranishëm ishin edhe përfaqësuesit e shoqërisë civile si dhe përfaqësuesit e mediumeve.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Antigona Bytyqi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Prizrenit, ku dhe i përshëndeti të gjithë të pranishmit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Të nderuar drejtor, zëvendës kryesues, media, shoqëri civile, të pranishëm, përshëndetje për të gjithë. Për sot kemi ftuar mbledhjen e dytë të rregullt të kuvendit për vitin 2025. Të pranishëm jemi 28 anëtarë të kuvendit, kështu që konstatoj se kemi kuorum për me i vazhduar punimet e kësaj seance. Dhe rendi i ditës për sot që është rekomanduar nga Komiteti për Politikë dhe Financa është ky:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të datës: 17 shkurt 2025 (solemne), 27 shkurt 2025 (rregullt), 05 mars 2025 (solemne);
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
3. Pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt Rregullores për Transparencë në Komunën e Prizrenit;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt Strategjisë për sigurinë në institucionet arsimore në Komunën e Prizrenit;
6. Raporti financiar për periudhën janar-dhjetor 2024;
7. Raporti i komisionit për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, për analizim e dëmit të shkaktuar nga fishekzjarrët në fundvit.
8. Raporti i punës së Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2024;

Pika e Parë

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të datës: 17 shkurt 2025 (solemne), 27 shkurt 2025 (rregullt), 05 mars 2025 (solemne);

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po fillojme pikën e parë, a ka dikush diçka rreth procesverbaleve? A keni ndonjë koment vërejtje sugjerim? Jo atëher po e hedhim në votim, prezent jemi 29 anëtarë. Kush është për që të miratohen procesverbalet? Unanimisht, ju falenderoj të gjithëve.

Pika e Dytë

Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): A ka dikush diçka me shtu? Po zoti Quni?

Shukri Quni (Nisma): Faleminderit kryesuese. Përshëndetje koleg kuvendar, përshëndetje media të pranishëm. Unë kam një propozim nga organizata e Vetranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës Dega në Prizren, domethënë pikërisht kryetari i OVL-së Isa Berisha. Që të hyjë në rend të ditës propozimi dhe t'i jepet titulli post-mortem qytetar nderi i Prizrenit, doktor Shaqir Shehut nga Kukësi. Nëse hyn në rend dite atëherë kishim shku më gjerësisht te biografia e doktorit, sepse doktori ka dhënë një kontribut të madh domethënë në luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në vitin 1998-1999. Po ashtu edhe në luftën e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare të Iliridës në Maqedoninë e Veriut viti 2000-2001. Andaj kërkoj që të më përkrahni, në fakt ta OVL-në e UÇK-së për këtë kërkesë që e ka bërë që të hyjë në rend të ditës edhe ta shpallim qytetarë nderi post-mortem doktorin. Kërkoj mbështetjen!

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zoti Çuni, a ka dikush tjetër propozime? Në qoftëse jo, atëherë unë edhe nga zyrtari ligjor meqë për procedura po mesa e di kjo kërkesë, nuk jam shumë e sigurt a është për këtë titull është edhe te kryetari ose duhet të vjen te kryetari, po megjithatë në interpretim ligjor po e marrim edhe prej se me procedura e jemi në rregull me propozuar në kuvend. Po zyrtarin e kisha lut.

Naim Kukaj (Zyrtar Ligjor): Përshëndetje edhe njëherë. Për sa i përket propozimit të las Shuk. Ju e keni miratuar një rregullore për ndarjen e dekoratave pra dy muaj ndoshta tre, se di sa i ka. Po aty parashihet me u formuar do komisione për me i pranuar ato propozimet edhe kërkesat. Edhe është tash është formuar dhe një komision për me i punuar edhe dekoratat. Tash a mund me hy me një mbledhje tjetër me i shqyrtuar komisioni tani me dalë në asamble, s'po jam shumë i sigurt. Po po më duket që duhet me dalë në komision njëherë. Rregulloren që kemi miratuar mbledhjet e fundit. Edhe e kemi formuar këtë javë një komision për formën e dekoratave dhe çmimeve qysh kanë me u duk, me dal edhe me miratuar edhe njëherë në asamble ajo formë edhe tani me mbet ajo pjesë e rregullores.

Haziz Hodaj (LDK): Faleminderit. Ju përshëndes kryetarin, kryesuesen, drejtorat e të gjithë anëtarët e kuvendit tonë, median. Derisa të bëhen këto komisione dhe derisa të hyjnë në fuqi kjo rregullore e re, ne vazhdojmë me të vjetrën. Domethënë, nuk mbetet vakant propozimi apo forma e punimeve në kuvend çfarë e kemi pasur deri thash. Kështu që propozimi i zotit Çuni për me e fut në rend të ditës nuk është problem. Na mujm me e aprovuar këtë këtë pikë të rendit të ditës.

Bëhet fjalë për një personalitet të njohur, të shquar që ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në luftën Çlirimtare të Kosovës, kështu që nuk ka asnjë problem. Nuk është shkelje e ligjit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Zotëri Hodaj, rregullorja e vjetër është shfuqizuar. Në qoftëse nuk keni njohuri domethënë jemi, procedurat për formimin e komisioneve me sa e di vetë që javën e kaluar kanë filluar. Duke u nisur prej praktikave të tjera, unë e di që këto propozime kanë shkuar te kryetari njëherë se përndryshe nuk është problem edhe e qesim në votim. Po sipas procedurave me sa e di unë nuk jemi në rregull me e propozu në kuvend. Drejtpërdrejt. Keni pasur raste edhe ju kur keni bërë propozime që i keni dërguar te kryetari, a është kështu? E kemi pasur edhe rastin me doktorin e me shumë të tjerë. Kështu që unë e vlerësoj që nuk është në rregull si procedurë po shumica vendosim edhe prej zyrtarit ligjor nuk pata diçka shumë një shpjegim kështu definitiv të qartë. Po unë kisha thënë e qesim votim tani deri në fund t'i shohim edhe e shqyrtojmë si pikë e fundit të jetë. Po zoti Karafil urdhërp.

Karanfil Haxhillari (LVV): Pra, siç tha zyrtari ligjor, këtu po duhej ka të formohet një komision për pranimin, e ky komision nga kush formohet? Rregullorja thotë nga kryetari, a është i themeluar apo mund të bëhet at hoc? Për këtë propozim, një. Në qoftëse nuk është ndonjë procedurë për themelimin e këtij komisioni që do të jetë në përputje me rregulloren, atëherë këtë propozim le ta merr qysh tani ky komision, le ta shqyrton dhe në mbledhjen sa më, pra në momentin kur t'ju kompletoheni me të gjitha format tjera, vetëm propozimi është i kryer. Unë po mendoj që për mos me shkuar procedurave procedurave, por sa më shpejt, meqënëse veç e kemi një propozim të gatshëm, le të themelohet komisioni, le të kryhen procedurat e dekoratave edhe ndoshta mbledhjen e ardhshme mundet edhe të kryhet ky akt.

Naim Kukaj (Zyrtar Ligjor): Komisioni ende s'është formuar prej kryetarit. Është formuar vetëm një komision për formën dhe kriteret për çmimet, për dekoratat. A për dhënien e këtyre dhe pranimin e kërkesave nuk është formuar ende. Me siguri brenda javës ose javën tjetër kanë me ardhur emrat edhe ka me dalë si vendim.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Mandej e diskutojmë si pikë të fundit edhe e shohim opsionin më të mirë. Atëherë propozime të tjera meqënëse nuk ka, ishte vetëm një propozim, po e hedhi në votim, prezent jemi. 32. Kush është për që të miratohet kjo pikë? Me hyrë në rend dite po. 31 jemi për. Zero kundër, 0 abstenim. Ju falenderoj të gjithëve. Atëherë rendin e ditës bashkë me propozimin i ri po e hedhi në votim. Kush është për që të miratohet rendi i ditës? 33 prezent. Ju lutem dorën edhe pak derisa t'i numërojmë. 31 për, 0 kundër, 0 abstenim. Ju faleminderit të gjithëve. Kryetar, mirë se erdhët në këtë mbledhje.

Pika e Tretë

Pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po, Marini fjalën.

Marin Përgjoka (LDK): Përsëendetje kryetar, të nderuar drejtor, kuvendar. Kam një propozim për drejtorinë e shërbimeve publike, nëse është e mundshme me ekspert, që i posedon kjo drejtori,

të bëhet matja e arsyeshmërisë që rrugët Kolonel Ahmet Krasniqi, Sali Çeku, Abdyl Pajaziti, Bajram Thaçi, Rexhep Kukaj dhe Gazmend Zajmi që janë afër drejtorisë së arsimit të shihet mundësia që ato rrugë të bëhen rrugë një kahshe. Që njëri krah të shfrytëzohet për parking, e krahun tjetër të jetë i lirë për qarkullim. Ato rrugë nëse dikuj i ka rën me kalu, është tmerr, është sikur me hy në tunel. Në dy anë ka makina, gjithmonë duhet me prit, me kalu njëra një makinë tjetrën. Nëse ekziston mundësia teknike dhe ekspert e drejtorisë së komunikacionit, faktikisht shërbimeve publike e vlerësojnë që bëhet një zgjedhje e problematikës edhe për parking për atë zonë, edhe për ata banorë, edhe qarkullimi i makinave bëhet më lirshëm. Atëherë, brenda mundësive, ta shohim se si mund të zgjidhet. E dyta, shumë prej nesh dhe kemi parë një postim një shpërndarje të lajmit, gjoja për një kontratë për që komuna e Prizrenit e ka dhënë në bazë të dokumentacionit të jo të rregullt dhe të pasaktë, mos me thënë të falsifikuar. Unë e di rrjedhën e asaj shpallje të tenderit prej fillimit dhe se komuna në fillim ka vendosur një operator tjetër ekonomik. Operatori i dytë që ka qenë kundër kandidatit, ka bërë ankesë në OSHP dhe OSHP-ja, e ka kthyer në fitues faktikisht e ka nxjerrë operatorin e dytë. Në ankesën e parë ka qenë çështja e çmimit më të lartë ose më të ulët që është një rregull që unë s'pajtona me atë në parim, por sidoqë të jetë është vendim, është ligj edhe duhet me u munduar me zbatuar. Mirëpo, në ankesën e operatorit të parë që ja ka dhënë mundësinë OSHP-ja me vendos, me e bërë ankesë, OSHP-ja prapë vendos në emër, në emër të asaj që operatorin e dytë. Unë s'po dua me përmendur emra se idhe emrat e operatorëve, po s'mund të bëj. Unë po besoj që është me rëndësi kryesuese për arsye se është me vepër penale kjo që ka ndodhur edhe nuk dua me lënë diçka me kaluar që konsideroj që nuk është në rregull. Operatori i dytë sipas kërkesës të shpalljes për shërbimeve shëndetësore, ka qenë i obligim që të prezanton referenca për punën e kryer në tri vjet e fundit para shpalljes së thirrjes për aplikim. Referencat të cilat i ka i ka prezantuar operatorin ekonomik, sipas hulumtimit edhe qasjes në dokumenta zyrtare të komunave që i ka prezantuar, që është Klina, është Juniku edhe Skenderaj, kanë dalë që janë kontrata në vazhdimësi, nuk janë kontrata të përfunduar. Kështu që, nëse nëse ka mundësi zyrja e faktikisht organi shqyrtues i komunës së Prizrit për këto, me bë verifikimin e atyre dhe eventualisht nëse ka një dokument që është nxjerrë jashtëligjshëm dhe është prezantuar si dokument që nuk i plotëson kriteret, minimalisht ta pezullon deri në verifikim këtë shpallje publike që mos të kalojmë me një vepër penale. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Ju kisha lutur për mirëkuptim që ta respektoni kohën prej dy minutash. Fjalën e ka Haziz Hodaj, përgatitet Karanfil Haxhillari.

Haziz Hodaj (LDK): Me thënë të drejtë, këto pyetje nuk i kam praktikuar shumë kohën e fundit po kam lexuar dhe një reagim të ish-drejtorit të urbanizmit të zotit Beni Kizolli, që kam konsideruar që ka qenë njëri ndër drejtorët më profesionist edhe më të përgjegjshëm në ish qeveri dhe sinqerisht më ka bërë përshtypje. Edhe nuk e disha njëherë se ku është për për cilin vend po bëhet fjalë, për për cilën hapësirë, për cilin lokacion. Domethënë dhe kur mora vesh që bëhet fjalë për parkingun këtu që realisht edhe nuk menaxhohet qysh duhet, sepse as zyrtarët e komunës nuk po kanë ku me parkuar makinat, le katrahurën që është rreth parkingjeve në qytet, sinqerisht u shqetësova. Nëse aty keni vendosur me e bë një qendër tregtare, unë ndash si mik, ndash si shok, ndash siç çka duash, i drejtona kryetarit ta tërheq atë vendim, se me u bë në pjesën e e mbrapme të shtëpisë bardhë një qendër tregtare dhe të arsyetohet se kanë me u bë 200 e kusur vende mandej të parkingjeve nëntokësore, ai parking nëse bëhet, ai nuk bëhet publik por bëhet ekskluzivisht për qendrën tregtare

që ka me u ndërtuar lart. Edhe nuk ka asnjë kuptim që me u ngulfat edhe kjo shtëpi e bardhë, që e ka një shesh shumë mirë që e ka edhe me mbetur ashtu, me bë një parking nëntokësor që shfrytëzohet nga qytetarët të Prizrenit dhe një shesh nalt do të ishte mrekulli e vetë. Përndryshe nëse bëhet qendër tregtare po them keni me qenë edhe të gjykuar, edhe të paragjykuar, edhe të përfolën gjatë tërë kohës në qytetin e Prizrenit.

Karanfil Haxhillari (LVV): Faleminderit kryesuese. Pyetja e parë shkon për Drejtorinë e Shërbimeve Publike. Ne e dimë që shtrati i Lumbardhit është i rregulluar pak a shumë nga Marashi deri te Mulliri i Vjetër apo tek Ura e Tabakhanës. Kurse nga aty deri te ura e Gjevries që përfshin edhe parkun e qytetit, shtrati i Lumbardhit është i parregulluar dhe në gjendje të tmerrshme. Tash po kthehem tek tenderi i famshëm ndërtimi i shtratit të Lumbardhit nga ura afër kampusit universitar në vazhdim të rrjedhës. Ky tender ka vlerë 2.2 milion euro, ku në brendësi të paramasave kemi elemente me çmime enorme si ulëse parku me 1700 euro, me parking për bicikleta të thjeshta me çmim prej 1200 euro, si dhe shumë elemente të tjera të cilët nuk krahasohen me çmimet reale të tregut. Pyetja për këtu është emërtimi i projektit është ndërtimi i shtratit të Lumbardhit nga ura afër kampusit universitar në vazhdim të rrjedhës. Vazhdimi i rrjedhës është deri ku bashkohet me Drinin e Bardhë. Por askund nuk ceket deri ku, sa metra gjatësi apo dal ku dal deri del kompania e kënaqshme. Pra 2.2 milion euro për sa metra gjatësi të rrjedhës së lumit do të paguhet ky tender. Pyetje tjetër një është nga shqetësimi që u ngrit edhe pak më herët, por, u kuptua që nënkalimi nga ish BVI-ja deri në Bazhdarhane si premtim i madh i fushatës tuaj elektorale ishte vetëm një mashtrim dhe kaloi nga një nënkalim në rrethrotullim. Në mjete të informimit kemi dëgjuar që pas largimit të objektit të ish lirisë po bëhet ndërtimi i rrethrotullimit në rrugën Adem Jashari, në lagjen Bazhdarhane. Pyetje të cilat do t'i ngrisë për këtë janë nën 1. Për ndërtimin e këtij rreth-rotullimi, a ka pasur debat publik me qytetarë paraprakisht? A janë pyetur bizneset dhe qytetarët e asaj pjese? Nën 2. a janë bërë planifikimet e duhura se ky rreth-rotullim do të çlirojë, apo do ta ngulfatë edhe më shumë qarkullimi në atë pjesë edhe ashtu të stëngarkuar? Kur ja shtojmë faktin që jo më larg se 100 m është rreth-rotullimi tjetër dhe i duhur, sepse rreth-rotullimet kryesisht vendosen ku janë kryqëzime rrugësh. Në mënyrë që të hapet gryka e lëvizjes së automjeteve me këtë rreth rotullim vetëm që do të ngulfatet edhe më shumë, siç ka ndodhur edhe në tërë qytetin me rrethrotullime vend e pa vend. Pyetje tjetër për këtë, me çfarë kode buxhetor përkatësisht me çfarë mjete po ndërtohet ky rrethrotullim? Dhe e fundit po vërehet qartë se punimet për këtë rrethrotullim kan arritur deri te objekti i Albanikës. E që sigurisht qysh e keni zakon në qatë rrugë të kryhet edhe shërbimet për shefin e kabinetit, me ua rregullu për shtati infrastrukturën e objektit privat. Po ashtu po flitet për një qendër tregtare këtu afër dhe më tregoni në shërbim të kuj po bëhet ndërtimi i këtij rreth rotullimi sepse nga përvoja që e dimë vetëm për shërbim të qytetarëve jo.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zotëri Haxhillari fjalën e ka Selman Sokolaj përgatitet Shqipe Shatri.

Selman Sokolaj (LVV): Faleminderit kryesuese. Një çështje që po e ngre sot, ka të bëj me transportin publik edhe pamundësinë e disa nxënësve, mbase jo shumë në numër, po e rëndësishme si çështje për shkak të ndjekjes së shkollimit të mesëm në disa profile që nuk i ofrojnë lokalitetet ku ata i kanë më afër. Në kuadër të kësaj, besoj që është një ndërmarrje shumë e madhe, mirëpo

njërën prej punëve që kish mundur me e kry është respektimi strikt i licensave të autobusave nga kompanitë e autobusave. Për shkak të ekonomisë së tregut, mos leverdisë së disa kompanive, disa linja nuk mbahen edhe pasojat i vuajnë nxënësit, pra fëmijët tanë. Tjetra ka të bëjë me një fenomen të transferimeve të paligjshme në drejtorinë komunale të arsimit. Ndërrimi të pozitave, ngritje në pozita, ndërrimi, transferimi i mësimdhënësve nga një shkollë në një shkollë, që pretendohet që janë të paligjshme, janë pa kriterë ligjore, mund të aludojmë në favorizim të individëve, mbase mund të ketë edhe korrupsion në këto raste, nëse janë të paligjshme, pse mund të ndodhin. Një problem tjetër që e kemi vërejtur kështu gjatë punës tonë si asambleistë në kontakt me profesionist, me mësimdhënës, është çështja e honorareve. Në komunën e Prizrenit, shumë mësimdhënës punojnë orë shtesë me honorar, mirëpo ka disave që nuk iu paguan honoraret. Ata që atyre që nuk iu paguhën honoraret ka një arsyetim pse dikujt i paguhet, e dikujt nuk i paguhet honorari. Edhe e treta ka të bëjë me shërbimet publike, shumica e buxhetit të komunës së Prizrenit, ka shkuar në shërbime publik, në drejtorinë e shërbimeve publike dhe jemi në fund të mandatit të qeverisë. Jemi në fund të mandatit të këtij drejtori. Rrugët lokale, rrugët që çojnë në fshatra, sinjalistika, ndriçimi, ndriçimi i ri i vendosur, mungesa e ndriçimit në disa pjesë, mosfunksionimi i ndriçimit publik, ka shkaktuar një kaos shumë të madh që mund të t'i bëjë qytetarët që të ndihen të pasigurtë në ambientet që jetojnë. Faleminderit shumë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zoti Sokolaj. Fjalën e ka Shqipe Shatri, përgatitet Shukri Çuni.

Shqipe Shatri (LVV): Faleminderit kryesuese. Unë edhe në këtë mbledhje ju drejtohem sërish Drejtorisë për Shërbime Publike. I nderuar drejtor zotëri Lamaj, kërkoj nga drejtoria juaj konkretisht nga sektori për transport dhe trafik, të bëjë sinjalizimin e vendndaljeve për autobus dhe vendosjen e stacioneve të vogla për pritje të autobusëve në fshatrat e Hasit. Me vendosjen e këtyre pritoreve, qytetarët e Hasit do të kenë një mundësi më të mirë për pritje të autobusëve dhe kuptohet është një siguri më e madhe për për ta. Ju faleminderit.

Shukri Quni (Nisma): Faleminderit kryesuese. Përhëndetje kryetar. Kam një çështje me i ngrit, goxha serioze është. Unë kam diskutu edhe disa herë këtu po tash është tu maer edhe mediat me një projekt që është duke u realizuar në fakt në thonjza, s'është tu realizuar fare në Nashec. Tek procka te gurrat e Suzisë ne e quajmë atë. Këtu është bërë kjo punë mos ta banalizoj sikur ura e fshejtë, kush ka ndëgjuar për urën e fshejtë, ose kalaja e Rozafës, që tri vite edhe asgjë nuk është kryer. Është një investim shumë i madh. Domethënë dikund 285.000 euro. Aty ka pasur me u ndërtuar vetëm shtrati i lumit, edhe nja dy stazha me kubza, të majtë edhe në djathtë, dikund 200 m. Ky projekt u zgjerua e u stërzgjerua, saqë nuk e di a do të ka përfundim a jo. Nuk e kisha ngritur sikurse ta kishin marrë seriozisht edhe drejtoria e turizmit po edhe operatori i punimeve. Kur është punuar gjithnjë ju kam dhënë lavdata edhe ajo çka e meritoni për punën e mirë që e bëni. Andaj kërkoj që kjo të sqarohet sot këtu në asamble. Është një investim goxha i madh. Drejtor i shërbimeve publike, me ty më së shumti kam pasur punë gjatë këtyre tri viteve që po shkojmë, po ka një projekt sikur pushka e Lilës është bërë, drejtor, veç po niset e me u realizu, hala s'e keni pre asnjë shirit. Po pres inshallah mos po kryhen. Andaj kritikën, kritikën janë për përmirësime jo për me u hakmarrë disa çka i ke aty në drejtorinë e shërbimeve publike, se ata s'mund me hakmerren mua, se janë të vegjël shumë. Sa herë i paraqes unë çështjet këtu, ata mundohen në hakmarrje, në

tëra drejtoritë po janë të vegjël ata me u hakmarr me mua. Te ndriçimi publik, në Nashec. U bë edhe kjo u teprua. Ka ardhur i ka heq llampat të cilat kanë qenë të reja. Edhe i kemi kërkuar me i vendosur për shkak se i kanë ndërruar Keds-i ato shtyllat. Ka prur llampat të vjetra, më duket i këqyra që tu pra në oborr të shtëpisë bardhë kish qasi llampat të vjetra. Edhe qysh ka thënë zotëria. Llambat e vjetra i kemi për fshat. E të rejat janë për qytet. Ai sistemi i vjetër, për katund çka mbesin ato këpucat e vjetra, në qytet me i shfrytëzu këto të rejat. Operatori këtë e thotë, i punimeve. Edhe kujdes ku i jepni punime se nuk është në rregull kjo punë. E bëra edhe një kërkesë për pastrimin e rrugëve për degët që po dalin në asfalt. Rruga Nashec-Tupec është e pakalueshme. Rruga Nashec-Kojush po ashtu. Edhe nëpër fshat po. Pastaj kam bërë edhe një kërkesë për largimin e mbeturinave, sidomos materiale të forta, beton e guri që po sjellin këto firmat të pandërgjegjshme, që këtu ka punë më së shumti inspektoriati me marrë me këto. Drejtori i bujqësisë, a ka mundësi ndonjë punim me bë në Has si drejtoria e bujqësisë për hapje të rrugëve fushore po edhe të rrugëve malore t'i quaj kështu. Kishte bërë mirë. E di që e zgjata pak por veç edhe edhe pak e kam te drejtoria e se është tash edhe fundi kryesuese. Te drejtoria e arsimit. Kryetar, një vendim që e keni marrë, unë e kam mirëpritur edhe ju kam falenderuar për rregullimin e një pjesë e të kulmit në shkollën fillore Luigj Gorakuqi në Nashec. Ky vendim është marrë edhe është nënshkruar nga ju me 17.10.2024. Unë kërkoja që mos të investohet dy herë, po të ndërtohet kulmi se ka qenë i paraparë 2026-ën. Unë kërkoja që ai viti, që ato investimet e 2026-ës të hyjnë në 2025-ën edhe do t'i ndërrohet kulmi. Drejtoresha e arsimit tha që kulmi këtë vit tha nuk rregullohet, do rregullohet vitin tjetër. Tash unë s'po e di a dita me u lut, a nuk ma kuptuat lutjen. Është një fjalë popullore që thuhet, ish lut njëri te Zoti tha, po s'ja realizoj kërkesën. Tha, "more Zot a s'dita me të lut unë, a s'më kuptove." Unë kërkoja për me ardhur e me u rregulluar 2025-ën, ndërsa për 2026-ën, as që kisha bërë kërkesë hiç. Andaj është mirë se shkolla është ka pik. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zoti Quni. Fjalën e ka Agim Muçaj. Përgatitet Bajram Kastrati.

Agim Muçaj (AAK): Përshëndetje kryesuese, përshëndetje kryetar, ekzekutiv i nderuar, kolegë të nderuar, qytetarë të nderuar. Unë për drejtorinë e shërbimeve publike sigurisht se është drejtoria më e ngarkuar po kërkesat edhe kërkesat e qytetarëve i drejtohen gjerësisht kësaj drejtorie. Është edhe një kërkesë e radhës e cila kam për fshatin Korish, drejtor, besoj se jeni në dijeni, vite shumë më herët në qoftë se s'gaboju në vitin 2007 është investuar në fshatin Korish rreth ujit të pijes së bashku me banorët e fshatit në atë kohë. Mirëpo, në atë kohë kasi projekt i parealizuar, do të thotë, me u finalizuar 100% pasi që janë ndërtuar një bazenë në një sasi prej 2 milion e 500 ml, mirëpo si projekt nuk është mund të ekzekutohet deri në fund dhe sigurisht se problemi edhe çështja është për uj të pijes element bazë i jetës. Kisha kërkuar që nga kjo drejtori së bashku me një grup të ekspertëve, apo në qoftëse ka nevojë edhe në bashkëpunim me hidroregjionin që të ndërtohet një grup profesionist të bëhet një analizë e mirëfilltë. Sipas disa informave që kam, me 100 deri në 150.000 ky projekt mund të finalizohet dhe të zgjidhet problemi i ujit të pijes në fshatin Korish, së paku për nja dy-tre dekada. Falenderoj në qoftëse ka mirëkuptim dhe besoj që edhe asambleja do ta jep ndihmën rreth këtij problemi për qytetarët e Korishës dhe veçanërisht për ujit të pijes. Çështja e dytë është pasi që në qytet po punohet në shumë rrugë. U dëgjuan disa kërkesa të kalojnë, mirëpo dhe unë jam që në çdo rrugëqë ka mundësi tash të investohet dhe që po investohet në qytetin e Prizrenit, rrugë të cilat janë një drejtim dhe ka hapësirë të mjaftueshme që të shfrytëzohet në

mënyrë çdo rrugë edhe për parking në njërin anë, ku mendoj që do të ishte një zgjidhje shumë e mirë për qytetin dhe vetë qytetarët dhe të gjithë banorët e lagjeve. Ju faleminderit.

Bajram Kastrati (AAK): Faleminderit kryesuese, përshëndetje për të gjithë. Pyetje për drejtorinë e shërbimeve publike. Drejtor, a do të vazhdoj projektin në rrugën vazhduese tranzitore nga Arbana për Bajram Curr. Kërkesa tjetër gjithashtu ka të bëjë me Drejtorinë e Shërbimeve Publike në rrugën nga Arbana në drejtim të Landovicës dhe për gjatë lagjes Dardania nga dalja deri në daljen tjetër është një distancë e madhe dhe është kërkesë e vazhdueshme e qytetarëve për një dalje apo rreth rrotullim tjetër në mes këtyre aktualve. Gjithashtu kemi edhe një kërkesë për një mbikalim në lagjen Dardania. A keni paraparë ndonjë projekt për këtë? Faleminderit!

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zoti Kastrati fjalën e ka Ertan Simitçi, përgatet kujtesa Kabashi Shatri.

Ertan Simitçi (Ythp): 32:00- 35:10

Kujtesa Kabashi Shatri: Unë po e ngriç që disa herë këtë çështje. Kryetari është në dijeni. Procka në Gjonaj nuk ka filluar për me u rregulluar. Ka qenë në kod buxhetor, është votuar, mirëpo kodi është hequr buxhetor, nuk e di arsyen, drejtori e din. Punimet nuk kanë filluar, kryetari e din shumë mirë, më ka përgjigjur ajo proc do të rregullohet. Dua një përgjigje kur do të fillon, se ajo nuk është qare pa u rregulluar, se parat janë ndarë dhe nuk është marrë kurrëgjë. Kështu që dua një përgjigje nga drejtori ose kryetari, nuk e di njëri e din. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zonja Shatri, fjalën e ka Ymran Fusha. Ju lutem anëtarët e tjerë në qoftë se dëshirojnë me e marrë fjalën le të lajmërohen.

Ymrane Fusha (PDK): Faleminderit kryesuese, përshëndetje kryetar, përshëndetje ekzekutiv, ju kolegë kuvendar, mediat dhe shoqëria civile. Kërkesa shkon te Drejtoria e Shërbimeve Publike. Drejtor mbasi që lagja Dardania është një lagje e madhe, kërkuar banorët, është kërkesë e banorëve të lagjes të caktohet një vend ndalim për autobusat urban, deri te rruga Merima Jakupi. Mbasi që lagja Dardania është një lagje e madhe, banorët kanë kërkuar që të caktohet një vend ndalim për autobusat urban deri te rruga Merima Jakupi. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju faleminderit zonja Fusha. Fjalën e ka Naxhije Memaj. Përgatitet Ilir Gashi.

Naxhije Memaj (LDK): Faleminderit kryesuese. Përshëndetje për të gjithë. Për drejtorinë e shërbimeve publike. Drejtor, si është e mundur që në lagjen Bazhdarhane të bëhet edhe një rrethrotullim në më pak se 100 m larg rrethrotullimit ekzistues. Ndërsa një kërkesë e imja e vazhdueshme që të bëhet një rrethrotullim në lagjen Bajram Curri, të ndërtohet një rrethrotullim tjetër sepse ku e keni çuar rrethin ju atje poshtë, afër 3 km larg nga lagja, jeni duke i maltretuar banorët e kësaj lagjeje. Prandaj kërkoj drejtor që të zgjidhet ky problem në lagjen Bajram Curri. Ju faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju faleminderit zonja Memaj, fjalën e ka Ilir Gashi.

Ilir Gashi (LVV): Faleminderit zonja kryesuese, përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Kryetar, a ka mundësi të lutem publikisht dhe singërisht me tregu se çfarë është problemi juaj me hapësirat

komunale, me hapësirat e lira? Pse ky hopi juaj çdo hapësirë të lirë me ndërtu nga një ndërtesë aty. Së pari i shkatërrove shtigjet malore për në Pasha qeshme. Pastaj hapësirën e lirë ose parkun e fëmijëve e shkatërrove dhe ja dhurove një organizate humanitare për të ndërtuar. Dhe tash ka ardhë rradha që edhe oborrin e shkollës Abdyl Frasheri me ndërtu palestër sportive. Pse ky hov? Këtu po vërej që ju keni problem edhe me fëmijë. Së pari ja u keni ndalur shujtat e fëmijëve. Ja shkatërruat parkun e fëmijëve, tash edhe oborrin dhe fushën e sportit në shkollën fillore Abdyl Frasheri dhe Hysen Rexhepi. Drejtor Qelë Lamaj, ju e njihni atë lagje shumë mirë. E dini mundësitë që i ka ai vend aty? Pse nuk reagoni edhe ju? E dini që qasja është e vështirë aty? Nuk ka hapësirë për parkingje. E dini edhe nevojën që kanë fëmijët aty për atë hapësirë, po edhe ju, edhe unë, edhe të gjithë të tjerët që banojmë aty, e dimë nevojën që kemi për atë, por ju si profesionist dhe me kontribut të jashtëzakonshëm ishte dashur në këtë rast me qenë i pari që e kundërshtoni këtë projekt. Tjetra kryetar, e bëni publike dhe nuk tregoni që Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka ndarë mjete për këtë projekt. Pse kaq tinëz? Pse nuk e bëni publike që është financim i Ministrisë, i qeverisë së Republikës së Kosovës dhe mundohuni ta mbuloni këtë fakt. Unë propozoj që palestra sportive mos realizohet aty, po të bartet te ekoregjoni që në këtë kuvend u bisedu që ekoregjoni duhet të bartet nga ai vend dhe ka hapësirë të mjaftueshme aty të ndërtohet në ekoregjon. Ka edhe hapësira të tjera jashtë qytetit shumë të përshtatshme. Tjetra, krejt çfarë keni premtuar kryetar që do të lironi hapësirat, do të krijoni hapësira të gjelbërta, krejt po punoni kundër asaj. Keni premtuar nënkallim e na dul në fund rrethrotullim. Një rrethrotullim që nuk është i nevojshëm për qytetarë, një investim i kotë dhe tollovi e panevojshme për qytetin. Drejtor, keni premtuar ndriçim që tre vite në lagjen Dardania, Jaglenicë. Prej qendrës sportive deri në Jaglenicë nuk ka ndriçim publik. Nuk punojnë semaforat. Vjen shtatori, thoni për mars, vjen muaji i mars, na premtoni për muajin shtator që tre vite e gjysmë po bëhen, nuk ka, nuk janë rregulluar. Te kthesa, hyrja e parë në ITP ose ish Kforin dhe në majë Mishelini ku është banesa e oficerëve, është një shtyllë. Dhe në atë shtyllë shumë shpesh po ndodhin aksidente si mungesë e ndriçimit. Tash shpejt ka qenë edhe një kurbetqi, ka pasur një aksident në atë vend. Shtylla vazhdon të qëndrojë e shtrirë për tokë dhe vazhdon të paraqitë rrezik për qytetarë. Vendosija e numrave tek, tek shtëpitë, nëse është projekt komunal, a mundet drejtori përkatës me na shpjeguar këtë projekt për vendosjen e numrave, pse ka ndryshime të numrave dhe pse ka disa numra në disa shtëpi? Faleminderit për dëgjim.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): A ka anëtarë të tjerë që dëshirojnë me e marrë fjalën e që nuk janë lajmëruar, po Faruku pastaj Petriti.

Faruk Tahiri (LVV): Faleminderit kryesuese. I nderuar kryetar, të nderuar drejtor, të nderuar koleg kuvendar. Kam pyetje për drejtorin e shërbimeve publike sa i përket rreth rrotullimit të Bellona. Është njëri prej rreth rrotullimeve që ka penguar vazhdimisht komunikacionin dhe e ka ngarkuar akoma më shumë atë rrugë. Çfarë është më e keqja gjatë një interviste në televizion, dëgjova që do ta bëni edhe një rreth rrotullim. Do thotë aty i keni katër rreth rrotullime në atë rrugë. Doni me bërë edhe një, me u bë pesë që me bllokuar komplet rrugën. Unë nuk e di a është kaq e vështirë me bërë një zgjidhje për lëvizje në komunikacion të lirshme në qytetin tonë. Nëse nuk keni kuadro të mjaftueshme dhe profesionistë të mjaftueshëm, ju e keni pranuar që nuk jeni brenda, është mirë të angazhoni ekspertë nga jashtë dhe ta zgjidhni këtë problem. Nuk është turp me bë gabim. Nëse rrethi te Bellona është bërë gabim, nuk është turp ke bërë gabim për shkak se

ke tentuar me bërë diçka. Po është turp me këmbëgulë në gabim. Që tre vite rresht kërkojmë që është problem, është problem, është problem. Nxënësit e shkollës teknike, ndonjëri nga profesorët që jep lëndën e komunikacionit me i marrë edhe me nxjerrë të qaj rreth rrotulim, ta jep konkluzionin që është gabim. Pse kam ngulni drejtor? E para, e dyta. Sa i përket reagimit të ish-drejtorit të Urbanizmit, i nderuar kryetar, do të ishte mirë që të na tregoni më shumë të na jepni detaje më shumë nga ajo që pash unë në aneks dhe specifikat që keni kërkuar në tender, dy katet e para të podrumit kërkohej të bëhen parking, kurse dy kate të tjera kërkohej të bëhen lokale. Ne nuk kemi shumë informata, siç e tha dhe Karanfli, investimet po bëhen nëpër lagje pa marrë edhe mendimet e qytetarëve, banorëve, dhe njerëzve me interes që jetojnë në atë lagje. Komuna është e komunitetit, edhe jo atyre që udhëheqin. Kur dojmë me bë diçka, ndonjë investim, do të ishte mirë që të bashkëbisedojmë me qytetarët për secilën investim që bëjmë pran tyre edhe rreth tyre. Andaj do të kisha kërkuar që të na jepni sqarime më të shumta se çfarë po ndodh me parkingun dhe lokalet mbrrapa shtëpisë së bardhë. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zotëri Tahiri. Fjalën e ka Petrit Hoxha. Përgaditet Bujar Hasani.

Petrit Hoxha(Guxo): Faleminderit kryesuese. I nderuar kryetar, drejtor, koleg kuvendar. Kam disa pyetje për drejtorinë e shërbimeve publike. I nderuar drejtor, para ca ditësh e kam bërë dhe një kërkesë për vazhdimin e ndriçimit publik në fshatin Kobaj, që lidh tek rrugat, ne qysh i themi lllagam i kadisi, e gjerë në fshatin Grazhdanik. Aty të veç është ndriçimi publik, veç ka nevojë për intervenim të disa poqeve elektrike. Ndërsa dhe kërkesa tjetër është një trotuar prej daljes së fshatit Vlashnjë deri në Kobaj. Qytetarët veç po dalin dhe po ecin dhe po rrezikojnë jetën e tyre nëpër asfalt. Është mirë që të rregullohet edhe kjo. Ndërsa sa i përket trotuarit në fshatin Kobaj, në fshatin Muradem, kemi dalë me punëtorët e Ekoregjionit dhe për hir të korrektség e kemi lënë që mbas Bajramit, sepse janë të angazhuar në pastrimin e varrezave që janë duke bërë nëpër fshatrat e komunës së Prizrenit. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zotëri Hoxha, fjalën e ka Bujar Hasani.

Bujar Hasani (I pavarur): Faleminderit, përshëndetje për të gjithë. Unë e kam një kërkesë nga ana e furnitorëve apo furnizuesve të cilët furnizojnë lokalet afarisite, të cilët janë në qytet. Dhe në momentin e furnizimit ato lokale që i furnizohen prej furnitorëve, policia rastësisht domethënë kur i takon në ndalesë në rrugë, i dënon. Andaj kërkoj që të ketë mirëkuptim ndaj këtyre furnitorëve dhe të bëhet një marrëveshje në mes të komunës dhe policisë që gjatë momentit të furnizimit të lokaleve mos të shqiptohen tiketat për dënime. Ndërsa pyetja e dytë është para një muaj aty para lokalit edhe pak më poshtë te shkolla Remzi Ademi, pashë firma Krasniqi e bënte ngjytjen e pusetave me shfajca aparat. Dhe prej kureshtjes e pyeta thashë mu duk diçka një zbulim i ri sepse deri sot s'kam parë që pusetat me u ngjtit me shfajc aparat. Dhe dhe një sqarim nëse mund me më dhënë cila është arsyeja dhe pusetat të cilat janë të vendosura janë të prera dhe pastaj të janë me beton. Aty ku vendoset betoni me asfalt s'ka shans me ngjtit, te shkolla Rremzi Ademi, i keni dy puseta që janë pre dhe i është vendosur betoni. Domethënë që faktikisht për një afat shumë të shkurt. Një sqarim, cili është ai me u ngjtit pusetat me shfajca aparat për ndonjë një vërshim apo në ndonjë fatkeqësi, ato pusetat që pastaj me shku me i pre edhe me i hap. Faleminderit për fjalën.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju faleminderit zotëri Hasani. Atëherë nëse nuk ka anëtarë të tjerë, po e kalojmë fjalën te ekzekutivi. Po edhe Albani pastaj fjalën kryetarit t'ia japim.

Alban Bislimaj (PDK): Faleminderit kryesuese, përshëndetje kryetar, ekzekutiv, koleg kuvendar edhe media, qytetar. Unë nuk kam ndonjë pyetje kështu konkrete, por desha të ndërlidhem diçka me kolegët pasi që ngriten disa çështje të ndryshme dhe të sqarojmë pasi që edhe drejtori do të sqarohet në lidhje me këta. E para sa i përket ndriçimit publik, kërkesa është bërë prej mëherët për fshatin Kobaj edhe është bërë një pjesë edhe vazhdon pjesa tjetër sepse ka qenë një kërkesë diku tjetër të kalohet dhe prap do të kalohet në pjesën të mbetur, domethënë ajo e kërkesës është për sqarim që është bërë më herët edhe ka me u përfundu. E dyta, duhet të ndërlidhim diçka me punimet që po bëhen në qytet edhe po e shohim çdo ditë që punimet janë tu bë të mira. Pavarësisht ankesave të kolegëve që këtu është terr, e këtu është zi, e këtu është keq. Por realisht ne mund të shohim që janë duke bërë shumë punime të mira. Tu nis te Barjam Curri sepse komuna e Prizrenit ka mbyllur disa hyrje dhe dalje dhe kështu që është një zgjidhje shumë e mirë në raport me qysh ka qenë. Së paku nuk shohim aksidente qysh kemi parë më herët. E dyta, u përmend shumë te rrethrotullimi. Edhe është fakt që rrethrotullimi edhe drejtori edhe kryetari e shohin çdo ditë rrethrotullimin te Bellona. Por aty unë e po shoh që shumë shpejt do të bëhet zgjidhje pasi që prapë ka elkosit do të ketë shumë objekte, shumë banesa dhe do të bëhet disa rrugica, sepse për ta zgjidhur problemin e rrethrotullimit te Bellona, duhet të kemi alternativë rrugë tranzitore na i them. E kështu që është e pamundshme njëherë të bëhen rrugë tranzitore, por në një të ardhme shumë të shkurtër unë po shoh që aty do të bëhet zgjidhja. Arsyeja është sepse për të shkuar te Hibi po them, apo në rrugë të Gjakovës njëherë për momente nuk ke rrugë tjetër pa kaluar qaty. E që ajo rrugë domethënë ma merr mendja që do të shkurtohet. Është duke u përmendur shumë edhe rrethrotullimi në Bazhdarhone. Unë mendoj që rrethrotullimi ta keni parasysh që nuk është një problem që është tu i bërë qytetit. Imagjinoni nëse rruga ose një udhëkryq është pa rrethrotullim, është me sheja, e rrethrotullimi po bëjka kolonë. Nuk mundet me ekzistuar ajo gjë. Thjesht rrethrotullimi është një një punë më e mirë se udhëkryqi me sheja, me semafor apo me rregulla. Këtë gjë duhet ta dini që është më e mirë udhëkryqi. Pse po bëhet kolona? Sepse e dimë në atë pjesë pse bëhet kolona edhe domethënë ky rrethrotullimi që është në Bazhdarhone është një veprim i qëlluar në raport me qysh ka qenë. Rrethrotullimi domethënë duhet të bëhet në atë raste edhe ku i kemi dy shirita. Nuk duhet të bëhet trupimi i shiritit, dy shirita. Patjetër duhet të jetë rrethrotullimi në atë vende në raport me situata të tjera. Faleminderit shumë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zotëri Bislimaj. Fjalën atëherë po ja kalojmë kryetarit. Kryetar fjala për juve.

Shaqir Totaj (Kryetar Komune): Më së pari po dua me ju përshëndet të gjithëve edhe me ju falenderuar për gjitha këto pyetje që i bëni se janë çështje me interes publik edhe janë të rëndësishme. Unë i shënova këtu disa pyetje për të cilat ma merr mendja që kam përgjegje, kurse për ato që nuk kam me siguri do të kenë drejtorat. Sidoqoftë për qato që mendoj që kam përgjegje do t'i jap disa komente. Marini e përmendi çështjen e avonetit edhe tha që është vepër penale. Konsideroj që a është apo nuk është vepër penale e konstaton vetë gjykata. Na mund me dyshu ose mos me dyshu. Mirëpo, e vërteta është se komuna dhe departamenti i prokurimit rastin kur e kanë vlerësuar e kanë dhënë një kompanie tjetër, disa herë ka shkuar në oSHP edhe e fundit është

vendim i premë i OSHP-së. Pavarësisht prej kësaj, kontrata nuk është e nënshkruar, sepse unë e kam diskutuar me Isën edhe i kam thënë, verifikoj pretendimet e Kenanit. Kontakto me OSHP-në dhe kontakto me ata që kanë lëshuar ato referenca dhe nëqoftëse ka dyshime që ato referenca nuk janë autentike, ndërmerri veprimet e nevojshme ligjore, po derisa të bëhen këto verifikime, kontratën nuk do ta nënshkruaj. Jo nuk bën tash.

Marin Përgjoka (LDK): Unë unë nuk thashë, unë nuk thashë që komuna e Prizrenit e ka dhënë. Unë kërkoja këtë që e tha kryetari, që komuna e Prizrenit në të vepron në kuadër të vendimit të OSHP-së. Komuna e Prizrenit e ka vendosur ashtu qysh është dashur. OSHP-ja e ka ndryshuar.

Shaqir Totaj (Kryetar Komune): Të rekomandoj me pas durim se kur fole ti na të ngumë me kujdes, e kuptova çështjen tënde, është çështje e rëndësishme, prandaj po t'i jap shpjegimet e nevojshme sepse ne jemi të obliguar me i zbatuar vendime të OSHP-së. Mirëpo, në qoftëse dikush pretendon që ka diçka që duhet me u marrë me ato, nuk do ta injorojmë. Nuk e nënshkruajmë kontratën pa i verifikuar pretendimet e avonetit. Janë apo nuk janë rregull, do ta tregon verifikimi të cilin ne do ta bëjmë. U përmend çështja e parkingut nëntokësor këtu dhe ndërtimi i qendrës tregtare. Nuk është informat e saktë. Parkingu do të ndërtohet por qendra tregtare jo. Mund të ketë një objekt i cili do të ketë hapësira për aktivitete kulturore, për aktivitete artizanale, cilat janë karakteristike qytetit të Prizrenit, por qendër tregtare definitivisht nuk do të ketë edhe është interesante se qysh një prononcim i një profesionisti bën përshtypje shumë më të madhe sesa informata e cila është zyrtarisht nga komuna e Prizrenit. U përmend nënkalmi si mashtrim nga ana e Karanfil. Tash ne kemi premtuar një nënkalm në fushatë elektorale. Mirëpo ajo që premtohet në fushatat elektorale duhet t'i nënshtrohet një vlerësim i profesional. Kur është bërë një vlerësim profesional, një studim i fizibilitetit, na ka dalë se na kanë rekomanduar një zgjidhje tjetër. Edhe ndryshimi nga propozimi apo nga premtimi elektoral edhe kalimi me një planifikim më racional në praktikë, apo implementimi i një zgjedhje teknike më racionale në praktikë nuk quhet mashtrim. Mashtrim quhet diçka tjetër edhe nuk do të merremi me ata se kush është mashtrues se kush është kush nuk është mashtrues. Procka në Gjonaj ai definitivisht do të rregullohet. Kur, ju kallzon Qela? Një qasje interesante me u duket se hapsinat publike janë shkatërruar. Hapësira qysh mund të shkatërrohet? Hapësira nuk mund të shkatërrohet. Edhe një fjali që singerishti nuk po të kuptoj, kryetari ka probleme me fëmijë. Ky është kualifikim, klasifikim totalisht iracional. Qysh kam unë problem me fëmijë? A je duke dit çka je duke folur? Jo jo, ti konstatove, po unë po të përgjigjem, po them që ti nuk je duke dit çka je duke folur. Kurse përse i përket basketbollit, këtu po pajtohem me ty. E mbas analizave, mbas reagimeve dhe tuat, e kemi parë, e kemi analizuar, e kemi marrë që është më racionale me ç'vendosur terrenin për me ndërtuar fushën e basketbollit. Kurse ne nuk kemi bërë marrëveshje me Ministrinë, po kemi bërë marrëveshje me Federatën e Basketbollit të Kosovës. Kurse Federata e Basketbollit të Kosovës, me sa unë e kam informata, ka marrëveshje me Ministrinë, sepse Ministria do t'i financojë ndërtimin e terrenve të basketbollit jo veç në Prizren, por edhe në shumë komuna të tjera. Po ne e kemi marrëveshjen me Federatën e Basketbollit të Kosovës. Po përmendën shpesh rreth rrotullimet. Në aspektin profesional, unë nuk jam ekspert i kësaj fushe, po ato që më kanë thënë profesionistët e kësaj fushe është një trend nëpër Europë që shumë udhëkryqje me semafora shndërrohen rreth rrotulimeve për shkak se janë më praktike edhe më funksionale. Edhe kët trend po vazhdojmë edhe ne. Edhe një fjali tjetër mu u duket interesante që e përmendni Faruku, edhe tha komuna është e komunitetit e jo e atyre që

udhëheqin. Normal që komuna nuk është e jona. Komuna, qyteti i takon qytetarëve, banorëve, mirëpo jemi me një sistem demokratik ku s'ka zgjidhje të lira edhe që ata qytetarë të cilët janë pronarë çdo gjëje këtu, ju kanë zgjedhur juve, na kanë zgjedhur neve edhe derisa të kemi mandat, ne jemi ata të cilët bashkë me juve marrim vendime, secilin kuadër të autorizimeve dhe kompetencave të veta edhe dëgjimet buxhetore mbahen, në dëgjime buxhetore merren propozimet edhe për çdo projekt nuk muj me organizuar referendum se nuk është praktike, nuk është funksionale, më shumë bën pengesë sesa që ndihmon realizim të punëve. Kurse te furnizimi i lokaleve në Sheharvan që e përmendi Bujari, nëqoftëse e ke pasur fjalën për Shadervan. Për Shadervan është një orar i furnizimeve i cili duhet të respektohet. Kurse për pjesën tjetër të qytetit ne nuk mujmë me bë marrëveshje me policinë që ata mos me i dënu se ajo kishte me qenë marrëveshje për moszbatim të ligjit. Domethënë është çështje e policisë, qysh e zbaton ligjin edhe kompetencat e veta përsa i përket rregullimit të trafikut. Ajo është problem i juve, nuk është i joni. Ju falenderoj për vëmendjen edhe për pyetje të tjera që janë më tepër të natyrës teknike, do t'ia japim fjalën drejtorëve.

Qelë Lamaj (Drejtore Dshp): Të nderuar kuvendarë, qytetarë të Prizrenit. Pyetjeve të kuvendarëve do të fillojmë me pyetjen e parë të cilin e bëni Marin Përgjoka rreth shumë rrugëve në qytetin e Prizrenit që ka nevojë të bëhen rrugë një kahëshe, është e vërtetë. Ne veç jemi duke punuar në atë drejtim, sidomos edhe në Ortakoll, e që kemi një problem të tillë me parkimin e makinave, kështu që ne sivjet kemi dhënë disa urdhëresa që shumë rrugë të cilat janë të kupëzuara dhe janë goxha në nivel jo të mirë të asfaltohen, të rregullohet ajo infrastrukturë që kur të rruga Zajmi. Kështu që shumë shpejt keni me pa veprime që ato rrugë do të bëhe njëkahshe, do të orientohen në një anë, parkimi i makinave dhe do të funksionizohet ajo punë. Jam shumë dakord me këtë, jo vetëm në Ortakoll, po edhe në disa pjesë të rrugëve një kashe kryesisht që janë në qytetin e Prizrenit. Pyetjes e dytë e Kuvendarit Haziz Hodaj rreth parkingut mbrapa shtepisë e bardhë, kryetari e sqaroi, sa për një sqarim ndoshta shtesë. Ë, shpesh u dëgju këtu që ish-drejtori ekspert. Nëse dikush ka punuar në urbanizëm, nuk do të thotë që është edhe ekspert i i urbanizmit apo i planifikimit hapsinor. Ne kemi bërë një projekt ne kemi bërë një projekt të fizibilitetit për fytin e ngushtë për atë nënkalim i cili na ka rezultuar që nuk do të bëhet një nënkalim aty por do të bëhet një zgjerimi asaj rruge e cila duhet të jetë një gjashtë metërsh, e kemi domethënë dy korsi i kemi bëhet zgjerimi i cili është kosto shumë shumë më e vogël edhe zgjidhja teknike më e mirë. Nënkalimi kjo rrug do të realizohet në mandatin tjetër të zotit Totaj. Me siguri që ka me pasur nevojë edhe ndërhyrjes në hartën zonale për me mundur me funksionalizimi. Kurse, projekti është plotësisht i plotëson kriteret e hartës zonale, ku ne kemi planifikuar, jo qendra tregtare. Harroni këtë, nuk është qendër tregtare, është shumë mirë e sqaroj kryetari, është një qendër e zejeve, të cilët Prizrenit ka me ja kthyer një far identiteti. Është një etazhitet pe plus 1, ka përmbi 250 parkingje që kanë me funksionalizimi me rreth rrotullime i cili veç po ndodh. Do të zgjerohet edhe një korsi në drejtim të Suharekes edhe aty komunikacioni do të rregullohet si është më mirë. Kështu që është mirë të vini në zyrë të Drejtorisë Shërbimeve Publike, t'i shihni projektet, do t'i merrni sqarimet e duhura, pastaj normalisht edhe komentet e juaja do t'i marrim parasysh. Pyetjeve të Karafililit nuk është kështu, nuk do t'i përgjigjem. Selmani rreth transportit publik, ky e hapi edhe ky s'është këtu. Shqipe Shatri vendosja e vendndalimeve për autobus lokal në rajonin e Hasit, normalisht ne si drejtori jo vetëm në rajonin e Hasit, po tërë territorin e komunës së Prizrenit, e kemi të identifikuar, kemi mjaft kërkesa, mirëpo mundësitë buxhetore janë të vogla. Kështu që me

rastin që do të kemi mundësi buxhetore, do të bëhen edhe ato vendndalime edhe për Dardani aty kur e bëni pyetjen zonja Ymran Fusha. Shukriu rreth ndriçimit publik, vetëm një sa për informim, i vetmi fshat që mundem me thënë që është se ka përfunduar ndriçimi publik po kompletohet, është Nasheci. Nuk është e vërtetë ë, mund të them se nëse operatori apo ndonjë zyrtari i imi ka thënë që po i hekim dritat e vjetra, po i bimë nëpër fshatra, kjo nuk duhet të jetë e vërtetë. Kjo duhet, normalisht që unë kam me e konsultuar edhe kjo nuk mund të ndodhë se atë ndriçimin e vjetër, ai i vjetri nuk punon. Ne e hekim të vjetrin, e qesim ndriçim të ri. Kështu që do të merret parasysh kjo vërejtje e juaja. Sa i përket pastrimit të shkurrave veç është dhënë urdhëresë. Mirëpo ne e dimë që e kemi një kompani e cila në tërë këtë territor nuk mundet brenda një jave t'i përfundojë krejt, po është dhënë urdhëresa dhe e vërtetë është që ndoshta jo dy muaj, po një muaj ka, mirëpo do të pastrohen shkurret për të gjitha rrugët të cilat ato u pengojnë, jo vetëm në Nashec, po po edhe nëpër pjesë të tjera të fshatrave. Agim, sa i përket pyetjes që ju ju rreth projektit i cili paska filluar në vitin 2007, nuk kam ndonjë informacion. Kam me marrë këtë informacion, ta shoh pse është ndërprerë ky projekt. Normalisht që do të kontaktojë edhe Hidroregjonin dhe ta shohim që në buxhetimin e viteve të ardhshme ta realizojmë edhe këtë projekt. Pyetjeve të Bajramit. Bajram ne i kemi veç projektin Arban- Bajram Curr. Ky projekt është i hartuar gjatë vitit 2023. Normalisht që kostoja është shumë e madhe. Ne kemi bërë projektin bazë hartës zonale ku aty kemi diku kemi identifikuar për mbi 13 shtëpi të cilat duhet të largohen. Normalisht që kjo është një kosto që me buxhetin e qeverisë lokale, besoni që nuk ka mundësi të realizohet. Presim që ndoshta qeveria qendrore do të kthehet nganjëherë edhe do të na investojë disa projekte të cilat janë jetike për qytetin tonë, i cili i cili tranzit kishte me shkarkuar bashkë krejt komunikacionin që zhvillohet brenda pjesës urbane të qytetit. Kurse për sa i përket mbikalimit kemi biseduar për edhe për Dardani, edhe për Landovic, për ka një mbikalim. Besoni që janë investime të cilët as ndonjëherë nuk janë shfrytëzuar jo vetëm këtu në Prizren. Po askund në Kosovë, janë projekte të dështume. Edhe nënkalimet, edhe mbikalimet nuk na kanë rezultuar, vetëm janë investuar, janë shkuar disa mjete dhe nuk shfrytëzohen. Shikoni vetëm nënkalimin që e keni në Zhurë. Ose në Piran. Absolut nuk nuk shfrytëzohet kurrë. Tash janë bërë vetëm qendra ku, grumbullohen mbeturina dhe papastërti të mëdha. Pyetjes e Ertanit rreth dizajnit të urave. Unë po ju them se ura e kalter edhe ura e Kforit do të bëhet me kalldermi e ri normalisht. Kurse për pjesën tjetër do të interesohem që me Institutin për Mbrojtjen e Monumenteve këtu në Prizren ta diskutojmë formën e një ridizajnit apo rekonstruimi apo rregullimi të këtyre urave dhe ta shohim bile ta kemi s'paku një projekt edhe të shohim se çka mundem me bë. Procka Gjonaj. Ku e kam me Egzonën këtu? E ne ne e dimë veç një që unë një prockë në Gjonaj jam duke e bë, po a i keni ndarë dy procka këtu nuk e di. Po besoj që një procka e di që është ndërtuar. Ka mbetur edhe një pjesë tjetër. Tash nuk e di se jo jo kishte qenë mirë që si komunitet. I keni edhe kryetarët e fshatrave, i keni edhe kuvendarët, jeni prej një rajoni disa partive politike, koordinon mirë, drejtorja shërbimeve publike ato projekte që ka mundësi me i realizuar, i realizon. Naxhije Memaj, rreth, rreth rrotullimit, rreth rrotullimit në Bazhdarhane janë dhënë sqarime, ato janë projekte qeverisë komunale e cila, normalisht që i ka konsultuar ekspertët edhe është punuar një projekt i cili ka me e rregulluar atë komunikacion që zhvillohet në atë pjesë të qytetit, kurse në lagjen Bajram Currin, Naxhije nëse kemi me pasur mundësi ta bëjmë shpronësimin e një pjese të rrugës Bajram Curri - Tusus ka me u vendosur edhe një rreth rrotullim. Momentalisht nuk ka kuptim rreth rrotullimi i dytë. Nëse dikush duhet me ec me makinë dy minuta e thotë ecin zjhtë e ullirit edhe në këmbë, hec njeri pesë minuta

pa asnjë problem jo me makinë. Nuk është problemi pse është një rrethrotullim diku 300 m, 500 m prej një rrethrotullim tjetër. Jo jo s'janë rreth 3 km jo. Po matni, 600 m e ke. Edhe 3 km le të hecet normalisht. Ilir Gashi rreth sallës sportive kam dhënë kontributin tim edhe unë si profesionist për atë objekt përgjigjen ja dha kryetari. Ndriçimi në Dardani prej ITP-së, ajo është ndriçim i ri. Çdo aksident që janë të përditshme që ndodhin edhe aksidentohen me një shtyllë, prishet komplet ndriçimi edhe tanë kohën si në rrugën Tirana edhe në këtë rrugë kemi mjaft probleme në zhvillim të këtij komunikacioni i cili njerëz i bëjnë dëmet edhe kërkojnë riparime. Në Dardania është dhënë urdhnesë të bëhet në komplet lagjen Dardania ndriçimi i ri publik. Edhe kjo rruga është e ndriçuar për kundër problemeve që ka siç e thashë se në aksidentet që ndodhin. Faruk Tahiri, rreth rrotullimit e Bellona. Ne e kemi e kemi miratuar këtu një projekt mobilitetit urban vitin 2022, kështu edhe në kuadër të atij ai projekt na ka thënë që është shumë e vërtetë që i vetmi rrethrotullim qytet është te Bellona i cili është i mbingarkum. Normalisht që ne kemi konsultuar edhe pjesë të tjera të inxhinierëve të komunikacionit që na rezultoi që një rrethrotullim tjetër i cili do të ndodhë në rrugën e cilana lidhur me lagjen Bajram Curri, do ta shkarkojë këtë komunikacion. Veç një dijeni që shkoni në qytetet më të mëdhaja të Evropës edhe keni me prit shumë më shumë në kolona seç e pritni në Prizren. Prizreni është qytet i cili funksionon komunikacioni në tërë territorin e Kosovës nuk ka më mirë. Shkoni ku doni. E dini këtë punë shumë mirë. Nëse mendoni që ju duheni tash, në pikën e verës ku kemi edhe kurbetqarë që na paraqitën kolonat që më së shumti mundesh me prit një pesë minuta, nuk e di tashti se sa, rrugët e Prizrenit janë këto që janë, nuk kemi rrugë me atë gjëra, ne jemi munduar që në forma ndryshme thashë nëse ka me ndodhë një rrugë e tranzitit ajo ka me shkarkuar komunikacionin. Qendrat tregtare janë ato dy qendra tregtare që na e paraqesin ,e dini krejt ju, normalisht që ne i kemi gjetur ato qendra tregtare janë dhënë atëherë nuk është menuar me kohën që është dashur ndoshta të mendohen hyrjet dhe daljet e atyre qendrave tregtare dhe do të jenë dika tjetër. Edhe këto e shkarkojnë, por nuk mendoj që komuna e Prizrenit ka problem në lëvizjen e lirë të makinave. Bujar, unë e kuptova drejtë këtë pyetjen e juaj. Drejtorja e shërbimeve publike ju jep pëlqime për ndalesa të kohë pas kohshme të gjithë furnitorëve të cilët kërkojnë furnizimin e lokaleve në unazën e qytetit. Këto ndalesa munden me qenë maksimalisht 10 minutëshe për të gjitha ato biznese të cilët na prezantojnë veprimtarinë e tyre edhe kohën kur ata kanë nevojë për furnizim. Nuk ka me pasur mundësi të ndalohen makina në krejt unazën e qytetit edhe të na zën një korsi, të majtën apo të djathtën. Ne kemi pasur tash, sa për kuriozitet, një kërkesë që njëri thotë me jep leje thotë mu, thotë që unë të vendosi klima edhe shpesh e ndodh me e lënë kerrin në rrugë deri sa ta vendosi unë klimën në një objekt privat. Ka edhe asi. Jo, po të them ka edhe asi. Po furnizimi për të gjitha lokalet të cilët e prezantojnë veprimtarinë, mund të vini, mund të vini në drejtori. Bëni një, jo jo jo jo, shenja nuk është. E bëni kërkesën në drejtorinë e urbanizmit na japim me hartë edhe e përcaktojmë, i kemi të rregulluar këto çështje.

Ramadan Tarashaj (Drejtor i Turizmit): Faleminderit kryesuese. Të nderuar drejtor, të nderuar asambleistë dhe ju media. Sa i përket pyetjes Las Shuk, kërkoj zgjidhje për Nashicin. Po, zgjidhja është La Shuk, brenda dy muajve do të përfundon projekti. Ka pas vonesa, e dinë edhe vetë arsyet pse kanë qenë vonesat, kështu që projekti si të rregullohet pak koha do të fillon dhe do të përfundon brenda dy muajve. Faleminderit.

Shukri Quni (Nisma): Drejtor, tri vjet po bëhet ai projekt edhe kam mendu që kryhet, e më për dy muaj, hiç e hiç. Po një send është thënë, që në takimin që të ka ardhur televizionet që po.. opozita ka qatë detyrë. Unë ju kam qar opozitës televizione të ndryshme ku kam qenë, po mendoj pozita kur ka qenë, kur jam kur kam qenë në opozitë. Bile, a e di çfarë kisha bërë me pas qenë në opozitë unë atëherë? Shyqyr që nuk e din. Televizionet është ka i sjell dikush. Nuk është që ju kam larguar un televizioneve, se jam ka flas publikisht, po kam menduar që do të kryhet, a di, mos me u thelluar. Tash duke e parë që me të vërtetë nuk është ka kryhet. Kryesia e fshatit ka qenë atë ditë kur ka qenë televizioni në vendin e ngjarjes. Edhe banorët, kërkesa është le të kthehet gjendja si ka qenë më përpara. S'po dojmë investim asgjë. Procka, lumi, qysh duash ta ta quajmë aty. Lumi i Suzisë le të kthehet në vendin e vet qysh ka qenë. Të hiqen ato mbeturina që janë sjellë aty, a ke pas se çka kanë sjellë? Aty kanë sjellë kupza që i kanë marrë nëpër vendpunishte tjetër kund, i kanë sjellë. Tash plus ka sjellë hidroregjioni ka pru dheh, ka qit aty. Ata vetë janë tu u shkatërru ata. Unë nuk e di çka janë tu bë ata aty. Këtu dikush është ka ndihmon mbrapsh me shku aty. Për atë thashë aty, se urën e fshejtë tash nuk e di qysh e dinë historinë e saj. Ajo, ditën është punuar, natën është prishur. Aty dikush është ka do me e prish, drejtor. Me një investim 285.000 euro. Nuk është pak. Qëtu me hy' ne tash me i numëruar, vallahi i bëjmë këtu do ditë, goxha do para janë. Bile unë i numëroj, them mos gabova, kthehna edhe njëherë. Nuk është në rregull tash. Nuk është një investim 10.000 euro ose 15.000 euro. Unë jam më shumë sikur ju i kënaqur me u rregullu ajo diçka fenomenal. Bile kam pasur propozuar kur e ka propozuar ish-drejtoresha e turizmit. Në fakt kur e ka paraqitur këtë projekt, thashë do t'ia ngjesim thashë pyete, do tregon, emrin parku i lirisë. Aq që bukur do të bëhet, asgjë nuk është tu bërë. Jemi tu i ndot tashmë edhe ujërat e pijes. Aman, po ju lutem, në emër të banorëve e të kryesisë së fshatit, hiqni ato mbeturina krejt aty, ato dhehna që i keni sjellë, ato kubza, ktheni shtratin e lumit si ka qenë. Edhe le të bëhet livadh edhe le të ka me hec në këmbë aty edhe s'po na intereson kurrëgjë. Të hunda na ka ardhur, s'po dojmë me investim më.

Ramadan Tarashaj (Drejtor i Turizmit): La Shuk, kështu sa i përket dheut që ka prurë Hidregjioni, ajo është pjesë e Hidregjionit, nuk ka në kompetencë tonën. Po sa i përket kupëzave, ai i ka pr, do të largohen ata sepse vetëm për qasje e ka pasur me i afruar materialet e veta aty. Se ndryshe s'mund me hy me makineri brenda. Ëh, projekti do të përfundon sipas që e thashë dy muaj edhe ashtu keni me quajtur prapë edhe ka me qenë ashtu qysh e ke paramendu dhe planifikuar vetë e keni bërë projektin, do të rregullohet. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju faleminderit edhe Faruku ka replikë.

Faruk Tahiri (LVV): Faleminderit kryesuese. Unë e dëgjova me vëmendje drejtorin dhe disa herë është bërë kjo pyetje sa i përket rreth rrotullit. Disa herë kemi marrë përgjigje të njëjta pothuajse po punohet, po punohet, po punohet për alternativë. Mirëpo i i dashur drejtor. Kemi unazën e jashtme të qytetit, e cila shköputet te tranziti vjetër, nuk vazhdon për me shku nga Nasheci pjesa e.. Kam një frikë që sa kemi heq për me liruar tranzitin e ri edhe më shumë do të heqim për me liru unazën e jashtme të qytetit. Për një operator, për një biznes, për një individ që ndërton, dëshiron me ndërtuar një shtëpi, nuk mundet me blloku komplet rregullimin e komunikacionit. Nuk mundet, nuk bën me leju. Andaj sa më shpejt bëni këtë alternativë të rrethit të jashtëm të qytetit, të unazës së jashtme. Që me funksionalizu sa më mirë, me marr frymë sa më mirë. Filloni ju, gjenden parët.

Komunikoni me ministritë, komunikoni me qeverinë, besoj kanë me ju ndihmuar. Po, projekti e ke, po projekti është në heshtje dhe aty po kanë filluar me ndërtuar në pjesën ku është parapa me u bërë rruga. Po. E para kjo drejtor. Sa i përket organizimit të komunikimit brenda Prizrenit. Vetë fjala që prej vitit 2005 kohën e Hanefi Muharremit me sa mbaj mend unë, është bërë një riorganizim i qytetit për komunikacion këtë rrugë të një kahëshe e këto nuk është bërë më asnjë ndryshim rreth kësaj lëvizje të komunikacionit, tregon që nuk nuk është punuar në atë drejtim. Prandaj unë thashë nëse keni mungesë të ekspertëve të komunikacionit brenda drejtorisë suaj, angazoni ekspertë të jashtëm. Mundësisht edhe disa ekspertë që kanë njohuri edhe mbi një gjuhë tjetër që kanë lexuar për komunikacion edhe me një gjuhë tjetër jo vetëm në gjuhën shqipe. Se rreth rrotullimet në përfundim i nderuar drejtor kanë edhe semafor. Ka rrugë qaq të ngarkuar nëpër përfundim që janë rrjedha i vazhdon lirshëm që habitesh se si vazhdon. Veç duhet punë, angazhim dhe vullnet, asgjë më tepër. E jo me këmbëngulur që zgjidhja më e mirë është veç rrethrotullimi. S'është zgjidhje më e mirë se e kemi parë, e ke hap një rrethrotullim, s'është liruar komunikacioni, ke shkuar e ke hapur edhe një tjetër, apert s'është liruar komunikacioni. Tash po do me e hap edhe një tjetër, po s'lirohet se katër i ke bërë aty. S'ka, po e sheh se me rrethrotullime se nuk ka hapësirë për rrethrotullime. Rrethrotullimit po bëhen jashtë standartit. Prandaj edhe po kemi këto probleme. Edhe sa i përket një replikë, sa i përket te kjo shumë shkurt e kam, sa i përket te pjesa e parkingut jashtë. Te mbrapa kësaj, drejtori po thotë që nuk ka qendër tregtare. Propozim konferencë ka majtë ish drejtoret që po thotë po supozon që është qendër tregtare. Ku po bazohet? Bazohet në specifikat teknike dhe estetike të detyrueshme që keni kërkuar ju në tender. Në podrum thotë sipërfaqja prej 3400 m² destinohet për parking. Podrum dy nënkatet destinohet për parking, kurse në 3 thotë përdhesa me sipërfaqe bruto prej 3000 m² destinohet për afarizëm, lokale afariste dhe kati më sipër përdhesë plus një kat, do të thotë në 3000 m² gjithashtu destinohet për afarizëm lokal dhe kjo le me dyshu. Ne për aktivitetet e artizanaleve kemi dhënë hapësira edhe janë bosh, nuk funksionalizohen sot. Ekipi e Mega Sportit, ka qenë aty nuk funksionalizohet. Ne kemi nevojë për parqe për qytetarë ku munden me kalu kohën e lirë gjatë jetës në qytetin e vetë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zoti Tahiri edhe i falenderoj të gjithë anëtarët e kuvendit për kontributin që e dhatë në këtë pikë. Atëherë po kalojmë te pika e radhës.

Pika Katër

Shqyrtimi dhe miratimi i projekt-rregullores për transparencë në komunën e Prizrenit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po zoti Berisha e ka fjalën.

Ymer Berisha (Zyrtar): Përsëritet. Unë qejfin e kam ju me u deklaruar këtu hiç mos me fol. Po tani unë s'po di cilin qëndrim me mbajt, po jam i gatshëm për të dyja. Nëse mendoni që dokumenti është pa rekselancë, le të votohet drejtpërdrejt, jam me ju. Po.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Nuk e di qysh janë shumica, atëherë po ja kaloj fjalën anëtarëve të kuvendit, në qoftë se keni ndonjë pyetje. A keni diçka me shtuar rreth këtij dokumenti? Po Ertani fjalën e ka.

Ertan Simitçi (Ythp): Faleminderit. Faleminderit për prezantimin zotëri Ymer. Shumë shkurt ke. Çështja është kështu. Para disa ditëve është bërë një ndryshim te web-faqja e komunës. Apo? Është rregulluar. A mundemi me ditë kush është kompetencë që e menaxhon këtë web-faqe, kush e rregullon, kush punon edhe pse pas ndryshimeve nuk ka publikuar më as informata të sakta në gjuhë të ndryshme. A ka ndonjë problem teknik apo është diçka mungesë tjetër?

Ymer Berisha (Zyrtar): Ertan faleminderit. Kur flasim, unë e kthej në kënaqësi edhe në besim edhe edhe kështu është kur e kuptojmë drejtë këtë dhuratë të Zotit se ka bimë edhe shtanëz të cilat nuk e kanë këtë cilësi dhe e dimë se çka i gjenë ato gjatë jetës së tyre. Kështu që është shumë mirë që e kemi në aftësinë e të folurit dhe kjo është mirë. Web faqja e komunës së Prizirit menaxhohet nga agjencia shtetërore e informacionit. Ashi, dhe ata mundohen me ruajt këto, se do të kemi sulme kibernetikë, ndërhyrje të kësaj natyre, të kësaj fushe. Edhe tash komunat ose institucione të tjera për shkak të ndjeshmërisë së madhe, e kanë përvetësuar si platformë të komunikimit. Unë e falenderoj në këtë rast edhe Seadin, nëse është këtui. Ë, ka ndërhyrë që në faqen e re na ka dalë që gjuhët të cilat i ka serbisht, anglisht, turqisht e jo boshnjakisht. Po në javën e kaluar kemi ndërhyrë teknikisht dhe sot nëse i qasni atje e kemi nxjerrë edhe akronimin Bos që i vjen akronimi për gjuhën boshnjake në web-faqen e re. Aspekti i sigurisë kibernetike është i qeverisë së Republikës së Kosovës, ndërsa aspekti i popullimit të informacioneve është i secilës komunë. Tani ne normalisht nga një web-faqe në web-faqen tjetër ju e keni parë nësi jeni përdorues nëse jeni përdorues të iPhone-it është ajo teknologjia për mos me i bartë numrat një nga një, veç e afron nga atë iPhone-it të ri dhe bëhet bartja në mënyrë elektronike. Kështu që në këtë mënyrë jemi tu i parë tash çfarë ka mbetur që nuk është bartur nga Web-faqja e kaluar në Web-faqen e re, qoftë edhe në gjuhët e komuniteteve. Përndryshe vullnetin e keni të qartë. Qeverisja Totaj, ka kërkuar ligji dhe asgjë tjetër. Data 1 janar 31 dhjetor të secilit vit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): A ka dikush tjetër diçka me shtu rreth po Faruku pastaj Petriti?

Faruk Tahiri (LVV): Falenderit kryesuese, unë me Imer Berishën kemi komunikime të vazhdueshme, e respektoj shumë dhe përgëzoj për punën që e bën, se i përket aspektit profesional, besoj që është njëri më i përgatitur në administratën e komunës, sa herë që kemi pasur nevojë për ndihmë, sa herë kemi pasur nevojë për ndihmë me të vërtetë shumë shpejt na u ka përgjigjur, sa herë që kemi kërkuar diçka qasje në dokumenta zyrtarë na është përgjigjur. Dhe besoj që një person i tillë është nderu ta ketë komuna brenda vetes së saj, që t'i jep një vlerë dhe më të madhe të gjithë administratës.

Petriti Hoxhaj (Guxo): Kryesuese në faqen e platformës Facebook, ende ekziston linku i web-faqës së vjetër dhe ka shumë prej njerëzve që dojnë me u lidhur dhe nuk ju bën. Kështu që është e mirë që të rregullohet edhe kjo.

Ymer Berisha (Zyrtar): Petrit, domethënë absolutisht je i drejtë në konstatim, por komunikimi i web-faqës së vjetër me të renë e shfrytëzojnë resurset njerëzore të komunës zyrtare. Ndonjë gjetje siç çfarë e pretendoi Ertani ose edhe dikush tjetër për ndonjë dokument se ne s'mundim tash me i kontrolluar të cilat dokumente nuk janë kthyer në këtë të renë. Nëse gjatë rrugës flisni për ndonjë dokument që nuk është, ne tash kemi të drejtë ai domen po quhet, e kemi Adnan Kurejshin po ju jap edhe emrin mbiemrin të zyrtarit të IT-së në komunë, po është në kuadër domethënë që që e

menaxhoj unë dhe e bëjmë më të mirën brenda pak minutave. E tani linku do të mbetet po nuk hapet për qytetarët. Është e mbyllur. Për arsye të mundësisë që dikush mundet me haku atë vjetër edhe krejt me bë dëme më të mëdha. Tash vetëm kur ka nevojë komuna ne kemi të drejtë me u qasur atje. Ju, ju ftoj që të komunikoni vetëm me vebfaqen e re dhe besoj që është një vebfaqe e mirë. Menaxhim unë thashë prapë është niveli qeveritar, edhe tek kjo rregullorja Bujar. Ka ndryshuar ligji që po ju jap dy elemente. Ligji për vetqeverisjen lokale thotë, brenda 15 ditë pas pranimit të dokumenteve bëhet validiteti i një dokumenti. Ligji për aktet administrative neni 10 i tij thotë, pas pranimit e dokumenteve 30 ditë, stand by i kemi aktive të dyat. E diskutam në politikë dhe financa me personat që kanë qenë atje. Tash, mirëpo ka dhe një autoritet të tretë që është etik edhe profesional që i bie ligji që është specifik për një punë të caktuar, është më i fortë ose ka fuqi administrative më shumë sesa një ligj i përgjithshëm. Që i bie, ligji për vetqeverisjen lokale flet për komunën në tërësinë e saj, ndërsa ligji për aktet administrative fletvetëm për aktet administrative dhe këtu është fuqia më e madhe sesa e ligjit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zoti Berisha. Dikush tjetër? Në qoftë se jo atëherë po e hedhim në votim këtë pikë, kemi 28 anëtarë, kush është për që të miratohet? Sapo e shoh Unanimisht. Ju faleminderit të gjithëve.

Pika e Pestë

Shqyrtimi dhe miratimi i projekt-strategjisë për sigurinë në institucionet arsimore në komunën e Prizrenit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zoti Berisha për gjithë raportotimin. Drejtoreshë, fjala për juve është.

Luljeta Veselaj (Drejtoreshë –DKA): Faleminderit kryesuese, të nderuar kuvendar, të nderuar media, të nderuar qytetarë të Prizrenit. Para jush ju keni pasur ka disa ditë një dokument që paraqet një strategji për sigurinë në institucionet edukativo-arsimore të komunës së Prizrenit. Kjo strategji synon të parandalojë rreziqet, të minimizojë incidentet dhe të promovojë një kulturë të mirëqenies në të gjitha shkollat tona. Përmbledhja e kësaj strategjie përfshin elementët për parandalim dhe edukim që kanë të bëjnë me fushatat ndërgjegjëse, sikurse edukimi i nxënësve, mësimdhënësve me sjellje të pasigurta dhe të për t'i kthyer ato në sjellje të sigurt dhe të përgjegjshme. Gjithashtu janë edhe disa, disa masa fizike të sigurisë që kanë të bëjnë me kontrollin e qasjes sikurse pajisja e shkollave me sistemin të monitorimit të kamerave të sigurisë, alarmeve dhe formave të tjera për të krijuar hapësira të sigurt në shkolla. Përgatitje për emergjencë që kanë të bëjnë me planet të evakuimit, sikurse është hartimi dhe ushtrimi i planeve dhe reagimi i emergjencave e kështu me radhë. Mbështetje psikologjike dhe sociale e cila lidhet me shërbimet e këshillimit sikurse disponueshmëria e psikologëve dhe këshilltarëve në shkolla me promovim të mirëqenies emocionale dhe aktivitete konkrete të cilat parashihen me planet e veprimit. Politika dhe legjislacioni që ka të bëjë me rregullore shkollare sikurse që është vendosja e rregullave për sigurinë dhe përgjegjësinë e gjithë hisedarëve që janë brenda institucioneve shkollare, e më së tepërmi duke ndjekur dhe duke u mbështetur nga organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve në shkolla. Pjesëmarrja e komunitetit e cila ndërlidhet me angazhimin e

drejtpërdrejtë të prindërve dhe familjeve në aktivitete dhe në vendimmarrje për sigurinë e fëmijëve, partneritete të ndryshme me organizata dhe bashkëpunime të ndryshme me institucionet të cilat e promovojnë sigurinë në arsim. Kjo strategji përveç këtyre komponentëve ka dhe masat konkrete të cilat i keni të detajzuara brenda dokumentit. Unë nuk do të zgjatem më shumë mirë por do të pres diskutimet dhe pyetje konkrete të juaja ose propozimet konkrete për t'i bashkëlidhur në këtë dokument që konsideroj që është shumë i rëndësishme për sigurinë e institucioneve shkollore. Faleminderit për vëmendjen.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju faleminderit drejtoresh. Atëherë fjalën po ua kaloj anëtarëve të kuvendit në qoftë se ka dikush diçka rreth këtij dokumenti? Po Florenti.

Florent Ukaj (LDK): Faleminderit kryesuese. U diskutua dhe në KPF drejtoreshë për pagesën e prindërve për sigurimin fizik nëpër shkolla. A do të vazhdon apo do të ndërmirni diçka në lidhje me këtë problem? Se kam pasur shumë reagime prej seancës, prej domethënë mbajtjes e KPF-së, më kanë shkruar dy-tre prindë, që a do të vazhdon apo çka do të bëhet me pagesën e sigurimit në shkolla. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit Florent, të tjer a ka? Drejtoresh nëse kemi përgjigje?

Luljeta Veselaj (Drejtoreshë –DKA): Po faleminderit Florent për pyetjen. E kam sqaruar dhe atë ditë në komision. Po e them edhe sot që sigurimi fizik nuk është i paraparë brenda strategjisë. Kjo është një dokument strategjik se si të krijojmë një siguri më të lartë në institucionet shkollore, ku brenda çdo komponente duhet të ketë edhe një plan të veprimit. Nuk mund ta bëjë vetëm Drejtoria e Arsimit të plotfuqishme këtë strategji. Kjo mvaret edhe nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, nga Drejtoria e Inspektoriatit, policia e Republikës së Kosovës, që i falenderoj edhe tani bëjnë një punë të jashtëzakonshme në komunën e Prizrenit dhe në institucionet shkollore. Kemi një bashkëpunim të jashtëzakonshëm, një bashkëpunim me prindërit. Sa i përket pyetjes konkrete për sigurime fizike, shkollat përmes këshillit drejtuese, e thashë edhe atë ditë, duke e vlerësuar rrezikshmërinë në afërsi të shkolla, vendosin sa do të kenë sigurim fizik apo nuk do të kenë sigurim fizik. E mora dhe një shembull që për pikëqefi ndoshta dikush qohet edhe e then një gjam të shkollës ose dy gjama, qysh na kanë ndodhur në një shkollë këtu në Prizren. Po kemi shkolla në shumë fshatra, domethënë gati të gjitha që nuk ka nevojë ndoshta sot supozoj as për një rrethojë, sepse komuniteti kujdeset shumë për ambientin e shkollës. Dhe ne duhet të edukohemi që shkollën ta ruajmë dhe ta mbështesim si vlerë të komunitetit, jo ta dëmtojmë edhe të kemi sigurime fizike, po kjo më varet, komuna nuk ka parapar një fond për sigurime fizike, atë e vendosin këshille drejtuese të shkollave varësisht nga rrezikshmëria në afërsi të shkollave. Faleminderit.

Ertan Simitçi (Ythp): Drejtoresh, në dëgjimin publik për strategjinë unë nuk kam kam pasur diçka personale, nuk mujta me ardhur në dëgjim publik, po po parashtroj këtu pyetjen edhe me marrë informata. Edhe para disa seancave unë kam bërë një kërkesë, një pyetje për çështjen e te shkollë Abdyl Frasheri. Kur është ndërtuar kjo ndërtesë, tani nuk ka shkallë emergjencë. Është ndërtesa trekatëshe, por nuk ka shkallë emergjencë. Kur është hartuar ky strategji, a është marrë parasysh edhe jo vetëm te shkolla Abdyl Frasheri, po të gjitha shkolla kur nuk ka kushtet të rregullon këto të bëhet një projekt i veçantë ndoshta me një buxhet shtesë të veçantë edhe të futet brenda strategjisë apo me një plan tjetër.

Luljeta Veselaj (Drejtoreshë –DKA): Janë të parapara brenda strategjisë edhe i takon bashkëpunimit që do ta kemi me drejtorinë e emergjencave. Janë edhe shkallët emergjente, po janë edhe trajnime të ndryshme që bëhen për situata krize ose situata të reagimit ndaj krizave të cilat ishallah s'ndodhin kurrë, po mund të ndodhin brenda institucioneve shkollore. Ju faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Të tjerë në qoftë se nuk ka rreth kësaj pike me diskutu, po e hedhi në votim edhe këtë pikë. 30 jemi prezent. Kush është për që të miratohet kjo pikë? rendi i ditës. 29. 29 jemi për, 0 kundër, 0abstenim. Miratohet pra edhe pika e pestë e rendit të ditës. Ju faleminderit.

Pika e Gjashtë

Raporti financiar për periudhën janar-ditor 2024.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Drejtor fjala për juve.

Sulltan Badalli (Drejtor i Ekonomisë): Faleminderit kryesuese, përshëndetje për kryetarin, ekzekutivin dhe gjithë ju të pranishmit kuvendar. Pra, po japim raportin financiar të planifikimit të buxhetit dhe shpenzimit të buxhetit për vitin 2024. Pra buxheti përdohet nga të hyrat e përgjithshme që në kuadër të hyrave të përgjithshme janë granti qeveritartë hyrat vetanake, të hyrat të bartura, huamarrjet, donacionet e ndryshme. Buxheti i vitit 2024 ka qenë i planifikuar në vlerë prej 71.447.000 euro, ndërsa shpenzimi i tij ka qenë 68.794.000. euro, do të thotë në total si shpenzim ka qenë 96.29%. Do të thotë që ka qenë një shpenzim shumë i mirë i buxhetit me krahasuar me vitet e kaluar. Ndërsa te të hyrat vetanake të komunës së Prizrenit për vitin 2024, planifikimi ka qenë 10.193.000, ndërsa arkëtimi ka qenë 10.446.000 që kemi një përqindje prej 102.48% ose një diferencë prej 253.000 euro në vlerë monetare. E kemi gjithashtu dhe të hyrat nëpër drejtori. Këto që nuk e di a ka nevojë me i përmendur për secilën drejtori. Ndërsa në tabelën është dhënë edhe një pasqyrë krahasuese e planifikimit të realizimit të hyrave vetanake për periudhën janar-dhjetor të vitit 2022, 2023-2024. Për 2022-ën kemi pasur një planifikim prej 7.366.000 ndërsa një realizim ose arkëtim prej 8.936.000 në përqindje 121%. Në 2023-ën planifikimi ka qenë 8.403.000 një realizim prej 10.601.000 ndërsa përqindja 126% për 2024-ën planifikimi ka qenë 10.193.000 realizimi 10.446.000 përqindja 102.48%. Ndërsa te shpenzimi i buxhetit e kemi nëpër kategoritë kryesore, e kemi te pagat e kemi një shpenzim të buxhetit prej 99.83%, te mallrat dhe shërbimet 97.40%, te shpenzimet komunale 82%, te subvencionet 97.72%, te investimet kapitale 92.28% dhe totali i investimeve ka qenë 96.29%. Pra kemi një buxhet të pashpenzuar prej 2 milion e 653 euro, ku nga ky buxhet kemi të grantit qeveritare kemi 494.539 euro e cila vlerë edhe do të shkojë në suficit. Ndërsa te të hyrat vetanake i kemi 880.000 të cilat hyra bartën nga komuna sepse janë të hyrat direkte komunale. Pa shpenzuar gjithashtu i kemi dhe të hyrat vetanake të bartura të vitit 2023, 69.000 euro. Të hyrat nga donacionet e brendshme dhe participimi 168.000 euro, si dhe të hyrëve nga huamarrja e cila qe tri vite na vjen si barrë neve që vazhdimisht përsëritet, 1 milion euro janë diku të cilët po ashtu hyjnë në kuadër të mjeteve të pashpenzuara të cilat mjete janë pa dëshirën tonë. Domethënë janë përmes Bankës Europiane për rindërtim dhe zhvillim, si dhe e Ministrisë që është një fond i ndarë në kuadër të efijencës së energjisë për institucionet publike të komunës së Prizrenit. Gjithashtu te shpenzimi nëpër kategori të të investimeve kapitale, e kemi një shpenzim shumë i mirë që është bërë në vitin 2024. Kemi një

total në përqindje prej 92.28%. Pra planifikimi ka qenë 25 milion e 816.000, ndërsa realizimi 23.823.000, pra një shpenzim që ka qenë shumë i mirë në krahasim me vitet e kaluara. Gjithashtu në tabelën e mëposhme kemi edhe një shpenzim të buxhetit për tri vite, të cilat vazhdimisht vit pas viti kemi ndryshime, po është një diçka shumë me rëndësi se kemi ndryshime pozitive në rritje do të thotë. Për 2022-ën totali i planifikimit ka qenë 55 milion, ndërsa shpenzimi 46 milion, në përqindje 83.74%. Vitin 2023 e kemi 69 milion, ndërsa 62 milion ka qenë shpenzimi 89.94%, pra kemi rritje në krahasim me vitin 2022, ndërsa për vitin 2024 është planifikimi ka qenë 71.447.000, ndërsa shpenzimi 68.794.000 përqindja 96.29%, do të thotë po ashtu dhe këtu kemi një rritje në krahasim me dy vitet e fundit. Do të thotë shpenzimi i buxhetit, menaxhimi i buxhetit kryesisht për vitin 2024 ka qenë shumë i mirë me krahasuar me dy vitet e kaluara. Kjo ishte në pika të shkurta, raporti financiar. Nëse ka pyetje diçka këtu jemi.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju faleminderit edhe drejtor, por zotëri Hodaj e ka kërkuar fjalën, pastaj edhe të tjerët nëse dëshirojnë.

Haziz Hodaj (LDK): Faleminderit. Këtij realizimit të buxhetit drejtor na ke kthyer kohën e Enver Hoxhës e keni realizuar për mbi 100%. Edhe për këto përgëzimet më të mira për realizimin e buxhetit. Por se si është realizuar dhe si janë shpenzuar këto mjete, këtu kjo len për t'u dëshiruar, sepse shumë projekte as që janë proceduar që janë parapar, jo brenda këtij mandati, por edhe brenda këtij viti kalendarik, as që janë nis. Dhe ku janë shkuar ato mjete, ju e dini shumë më mirë se ku janë shkuar. Edhe disa herë e kam përmendur edhe i kam thënë edhe e kam porositur kryetarin. Mbas një mandati kur shkon prej qeverisjes, se konsiderohet që shkon, sigurisht se drejtori tha për po bëjnë plane edhe për edhe për mandatin tjetër, pra ajo mbetet për t'u parë sepse kemi një proces zgjedhor që na pret dhe duhet me kaluar nëpër të. Por një mandat është mjaftueshm që një kryetar të mbahet mend edhe për një realizim së paku një projekti kapital të qytetit të Prizrenit. Dhe e kam përmendur disa herë po e ripërsëris. U përmend këtu në fillim shtrati i Lumbardhit. Është njëra ndër kërkesat e mia të kahmshme edhe në legjislacionet e kalume, po edhe në këto pasaqërisht. Por fjala ka qenë gjithmonë për shtratin e Lumbardhit në qytet, në qendër të qytetit. Që ajo është një do të duhet të jetë një atraksion i qytetit Prizrenit dhe nuk është prekur qysh në kohën e Titos. Bëhet investime 2 milion euro në pjesën e poshtme atje, ku nuk i hyn në punë, nuk i hyn në punë qytetarëve, por i hyn në punë ndërtuesve. Dhe kjo ekskluzivisht bëhet për ndërtuesit. Për ata që vazhdimisht përfitojnë. Domethënë edhe tash ju rregullohet infrastruktura. E kemi kryqëzuar Mytaher Haskukën, për karrikat për ulëset 990 euro e kemi kryqëzuar në çdo seancë ja kemi përmend. Dhe tash për të njëjtat karrika, për të njëjtat ulëse çmimi është diku 1700 euro. Jo sinqerisht, sinqerisht është një keqpërdorim i dukshëm që e sheh secili prej nesh. Një ulëse se ne blejmë ulëse edhe nëpër oborrë ulemi edhe e dimë sa kushtojnë. Po të llogaritet mbi 1000 euro, sadoqoftë ajo, është vërtetë absurditeti i llojit të vetë. Dhe kjo është një keqpërdorim që, që duhet me e hulumtu pse, pse janë duke ndodhur këto keqpërdorime? Është përmendur vazhdimisht teleferiku për kalanë për me shkuar në kala. Premtim elektorale. As që duket dikund. Parkingjet, e thashë në fillim, katrahur në qyteten e Prizrenit. Edhe ato parkingje publike që janë që kish mundur me përfutur komuna, nuk janë tu menaxhuar qysh duhet, nuk menaxhohen fare se jo nuk janë tu menaxhuar. Ato keqpërdoren në formën më të keqe të mundshme. Që ku keni e keni parkingun këtu që me muaj qëndrojnë makina, automobila këtu dhe zyrtarët e komunës të administratës nuk kanë se ku me i parkuar automjetet e veta. Mos flasim për tjerët, për parkingun ktu, dhe parkingjet

të tjera publike. Dhe shih për këto, këto parkingjet private luajnë me qytetarët, varësisht prej frekuencave të njerëzve. Nëse e shohin në mëngjes që ka njerëz shumë dhe ka kerre shumë, e rritin çmimin, e ulin çmimin pa asnjë kontroll. Domethënë një parking nëntokësor i premtuar që s'është s'është kërkund. Kemi menduar që do të procedohet dhe do të nisë ai parkingu atje që e miratuar te ajo bomba e vogël, megjithëse ai nuk e zgjidh problemet as për sa afër me qytetarët të Prizrenit. Tani këtu paralajmërohet megjithëse është parapa 500 vende tash paralajmërohet me u me zbritur, me u ulur numri i parkingjeve dhe ai sigurisht megjithatë që kryetari tha do të jetë një qendër zeytare ekskluzive e zanateve të Prizrenit. Unë megjithatë aty s'kisha parapa kurrëgjë ndërtim lartë përveç se një sheshi mbi një parking të madh që do ta çlironte dhe do t'ia çilte frymën qytetit të Prizrenit për parking. Kështu që po them mjetet janë realizuar janë shpenzuar ju e dini çka keni bërë me ato mjete, hiç kubza vëndo kubza, prish rrugica, ndreq rrugica në shumë vende prej tyre ku s'ka pasur nevojë as të prekin. Kështu që, e keni realizuar hallall u koftë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ju faleminderit zotëri Hodaj. Ju kisha lutur veç pak se harrova, e kam një kërkesë me i larguar nja dy vetura. Vetë t'ju tregoj tabelat, ju kisha lutur se e keni zënë rrugën 04334-kt edhe tjetra 04507-KS. Nëse ka mundësi me dalë edhe me e lirë rrugën. Po, po. Po kryetari e ka kërkuar fjalën, kryetar urdhëro.

Shaqir Totaj (Kryetar Komune): Më bëni përshtypje Hazizi kështu, jo për atë çka tha, por mënyrën qysh e tha. Me një ton të nalt, goxha binds. Me bë mos me e dit njeri gjendjen aktuale në qytetin e Prizrenit, terezi me i besu. Megjithatë, Hazizi tha që një mandat mjafton me bë një projekt kapital, po unë e mendoj që s'e kemi plotësu këtë kërkesën tëndë se e kemi bë më shumë se një. Edhe ti e di që e kemi bë, po ne jse është koha e vitit zgjedhor, duhet me fol nga pak. Kurse për pjesën tjetër u përmendën disa çështje kontestuese problematike, ato t'i shpjegon Qela, përse i përket përqindjes përmbushjes premtimeve elektorale sipas analizës së Institutit GAP diku 2/3 e janë përmbushur deri më tani, kurse përqindja e shfrytëzimit të buxhetit është një indikator relevant i performancës financiare të komunës e mënyra qysh janë shfrytëzuar ato mjete s'kanë pasur ku me shkuar përveçse nëpër projekte të komunës së Prizrenit, të cilat bashkë me juve i kemi aprovu. Po sidoqoftë të falenderoj për kontributin.

Haziz Hodaj (LDK): Kryetar, a ka mundësi me ma dhënë një projekt kapital që do të mbahesh mend në qeverisjen katër vjeçare, do të thojnë edhe pas 20 vjete e ka bërë Shaqir Totaj. Përveç këtyre infrastrukturësh, normalisht që se ki obligim se se 75 milion euro diku do të shkojnë, po një projekt që e ka emrin Shaqir Totaj.

Shaqir Totaj (Kryetar Komune): Projekt me emrin Shaqir Totaj s'ka.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po drejtor urdhëro, pastaj Farukt ja japim fjalën.

Qelë Lamaj (Drejtor-Dshp): Shpesh këto në këtë kuvend folen të pavërteta. Është është shumë mirë, është shumë mirë me pasur informacionin e saktë edhe dilni këtu edhe pastaj diskutoni. Sa i përket Islam, edhe ti ke mundësi me mësuar shumë. Një projekt, Drejtoria e Shërbimeve Publike ka një biro projektues i cili i harton projektet. Edhe kur të na sjell te ne projektin në drejtori, normalisht që merrim edhe ne me kontrollin e atij projekti, por ai e bën një deklaratë në rrugëtim që zotohem që krejt ky dokumentacion i prezantuar është i bazuar në rregulla dhe ligje. Ekziston ajo! Ejani edhe e shihni. Qatë projekt ne e çojmë në zyrën e prokurimit. Edhe as te një pozicion as

nuk i hiqet, as nuk i shtohet. Çdo operator ka drejtë, ka drejtë me e qit një çmim të vetin, a e qet 2€ a 2000€ a 3000€ por që ai operator i cili ka qenë i përgjegjshëm ka përfituar një projekti cili sot është duke u realizuar. Është shumë e vërtetë që brenda këtij projekti, ofertuesi e bëni dallimin rreth atyre 999 eurove Haziz edhe kësaj. 999 euro edhe 11 euro kanë qenë vetëm paramasë pa projekt. Edhe ato e kanë qit edhe i kanë dhënë urdhëresa që të furnizohen me 999 euro ulëse. Kurse ky ekziston brenda projektit që ka dhënë një çmim operatori, i cili sot është përfitues. Me kërkesën e kryetarit të komunës, në këtë rast, i kemi me një revidim ndërhyrje, i kemi larguar se kanë qenë dy-tri ulset që s'kanë lu peshë në çmimin e për mbi 2 milion që është ky projekt. Rregullimi i shtratis edhe kur të realizohet ky projekt me siguri edhe ju keni me qenë shumë të kënaqur. Edhe janë larguar prej paramasës pozicioni i këtyre ulëseve. Këto ulëse nuk janë as përafërsisht ato ulëse të cilat janë bërë 999 euro në ish qeverinë e kaluar. Kqyrni mirë çfarë ulëse janë. Pyetni prodhuesit e të këtyre ulëseve se sa kushton një, se nuk ka mundësi nëse dikujt shkohet një çmim për tri ulëse që kanë me u vendosur aty, edhe ai ka me mujt me qit një çmim, nëse nuk është afërsisht produkti të cilit kërkohet që ka një vlerë të tillë. Bile bile, shihni se hartuesi i projektit ka dhënë çmim shumë më të lartë, apo çmim më të lartë sesa që ka bërë ofertuesi në pozicione të caktume në këtë rast edhe në këto ulëse. Këto ulëse nuk kanë me u qit, vetëm për shkak këtij opinioni të cilit ju mundoni me e shtrembuar edhe me e dezinformuar qytetarët. I kam afër 100 projekte, nuk e di. Mundeni me ardh?

Haziz Hodaj (LDK): Ju duhet ta dini se po ju po më demantoni.

Qelë Lamaj (Drejtör-Dshp): Po, mundeni me ardh? Unë ju them diçka, se kjo ulëse është me çmim të ofertuar më lirë sesa që e ka menduar hartuesi i projektit. Projektet nuk i bën DSHP-ja, i bën kontrata. Kërko qasjen dokumente zyrtare ke mi pas krejt. Janë komisionet të cilët e përzgjedhin atë. Me pas pasur një pa rregullsi lënda shkon në OSHP. Edhe janë do gjykata të tjera të tenderve të cilët reagojnë. Nuk ka as te një mundësi keqpërdorimi në këtë rast. Faleminderit drejtör.

Shaqir Totaj (Kryetar Komune): Haziz, veç një informacion po ta jap kështu të përmbledhur në shkurt. Te kontrata, i kemi pa disa pozicione të cilat janë qenë të diskutueshme edhe me aneks kontratë ato pozicione i kemi larguar. Qato pozicione që i përmende, karrika dhe nuk e diçka tjetër, kur i kemi parë që janë të dyshimta, me aneks kontratë, marrëveshje, aneks marrëveshje, i kemi larguar ato, nuk do të përdoren qato pozicione.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit me radhë, Florenti edhe ti do ta kesh fjalën e ka Faruku, pastaj e ka Petriti, Islami edhe Florenti.

Faruk Tahiri (LVV): Faleminderit kryesuese. Kur e lexojmë raportin financiar të vitit 2024 dhe shohim realizimin e këtij buxheti, duhet me i përgëzu një, për planifikim të mirë edhe dy për efikasitet në ekzekutimin e projekteve. Se nuk ka shpjegim tjetër, nuk mundesh me i dhënë shpjegim tjetër. Nëse ke planifikuar shumë mirë dhe ke pasur efikasitet në ekzekutimin e projekteve mundesh me realizuar 100%. Asnjë formë tjetër smundesh me realizu. Tash pasi e lexon këto vish në këto përfundime, veç nëse hyjnë në analizë të shpenzimeve, e sheh një detaj shumë interesant. Shpenzimet, pagesat e kryera sipas vendimeve gjyqësore, do të thotë ne kemi diku 5.5 milion euro të marra nga buxheti i komunës nga përmbaues me vendime gjyqësore. Nga ato 1

milion kemi për paga, 1 milion kemi për malla dhe shërbime, kurse 3.2 milion kemi për shpenzimin e kapitale. Një pyetje që mund të lindë nga kjo, pse ka nevojë përmbaruesi t'ja merr parët komunës nëpërmjet vendimeve gjyqësore? A ka komuna përfaqësues ligjor e cila mundet me i prapësuar këto vendime apo këto kërkesa të përmbaruesve privat? Nuk është e mundshme 5.5 milion, me siguri do të ketë këtu mbi 1 milion euro shpenzime që i kanë shkruar komunës kot për shkak neglizhencë. Do thotë, cila është arsyeja që duhet mjetet me i marrë me përmbarues privat? Jo, jo, në kontrata kolektive i ke 1 milion. Mallat dhe shërbimeve i ke 1 milion. 3.2 milion e ke në shpenzime kapitale. Çfarë do me thënë kjo? Domethënë që 4 milion euro nuk kanë mujt me shpenzuar me buxhetin e planifikuar, po e kanë detyruar kompaninë që nëpërmjet vendimit gjysore t'i marrin mjetet nëpër ato kode buxhetore në të cilat tani nuk kanë mundur me i shfrytëzuar, për mos t'i kthym mjetet mbrapa. Andaj, edhe kërkesa ka qen për me parë se cila është arsyeja që 5.2 milion euro merren në vendime të gjykatave dhe nuk i jepën direkt, pagesa si bëhet operatorëve. Atëherë po dalim si komunë, e cila jemi borxh, borxhlit të këqij. Se veç borxhliveve të këqij, i mirret me përmbarues. Të tjerët janë okej.

Sulltan Badalli (Drejtör i Ekonomisë): Faleminderit, kryesuese. Kjo është siç e tha dhe kryetari si pasojë e kontratës kolektive, deri në 80% mundemi më me thënë. Pse? Sepse kur merren përmes kontratës kolektive, përmes përmbaruesit, përmbaruesi i merr mjetet ku i gjen nëpër projekte të caktume, se në paga nuk i merr mjetet, se nuk i lejohet me i marrë, se pagat nuk preken. Tash, çfarë bëhet? Normal ai që ta prish planifikimin që e ke bërë ti me kohë, edhe detyrohet operatori ekonomik me gjetur zgjidhje të tjera. Kjo është një mundesh me me thënë që deri në 80% kjo na ka na ka dëmtuar në çrregullim të planifikimit të buxhetit. Faleminderit.

Shaqir Totaj (Kryetar Komune): Që edhe po ta jap një skjarim, ndoshta ta mbush mendjen. Mjetet merren te investimet kapitale, mirëpo i mbulojnë obligimet e kontratës kolektive. Edhe përveç të tjerash domethënë përmbarimi është kategori ligjore edhe këto janë gjëra të cilat ndodhin nuk është e jashtëligjshme. Procesi i përmbarimit, si pasojë e kontratës kolektive përveç që na zvogëlon buxhetin edhe na çrregullon planifikimin e buxhetorë edhe hipotetikusht me pasur një gadishmëri më të madhe të qeverisë qëndrore për me bashkëpunuar me krejt komunat jo veç me neve, pasojat kishin me u zvogëlu, mirëpo kjo nuk ka ndodhur.

Islam Thaçi (LVV): Faleminderit kryesuese sinqerisht nuk kisha plan të kyçesha në debat në këtë pikë, po drejtori Qelë Lamaj më nxiti. Fillimisht zotëri Haziz Hodaj, unë s'e kuptoj një gjë në këtë shqetësimin e juaj, kur po pyetni pse ku shkun edhe çka u bë për këto tri vite. Për shkak se me sa po e mbaj mend ju dhe subjekti juaj dhe disa kolegë të tjerë e kanë votuar buxhetin, për këtë qeverisje, jo vetëm për vitin 2024, por edhe për vitin 2023. Çuditërisht nuk e keni parë çka keni votuar, apo s'keni desh me lexu çka keni votuar. Po ja rikujtoj të gjithëve për investimet kapitale të kryetarit Shaqir Totaj. Kryetari Totaj do të mbahet mend si kryetar, i cili ka shtruar rrugën e vetë para shtëpisë së vet me tepi të kuq. Talent është nofka juaj i nderuari kryetar. Ne asnjë projekt tjetër s'kemi pas tepi të kuq, kështu që veç në rrugën Shuaip Spahiu. Drejtör Çel Lamaj. Sa i përket karrikave, epitelin mundemi me ja ngjit si asaj shtyllës smart karrika jeni te montu. Se diçka qenkan ekstra, a e kupton! Hajde tash ja pesë minuta për karrigat e 1000 e kusur eurove me na mbajt ligjëratë. Mos të kisha qenë ekzekutiv e mos t'i kisha ditë këto, a e kupton, procedurat duhet të mbash mend që vitin 2024 për çdo kontratë i kishte shtuar nga 10%. E kjo është për me u hetu.

Çdo kontratë e jotja këtu kolegëve kuvendarë p'ja rikujtoj se kanë votuar bartjet e mjeteve, bartjet e mjeteve. Do thotë s'ka kontratë që s'i ka 10%. E të gjitha këto duhet me u hetu.

Shaqir Totaj (Kryetar Komune): Po më vjen mirë që Çela paska nxit Islamin me fol, po megjithatë mu duk pak interesante se kam ditë që jam që aq pasanik që e paska një rrugë në qendër të qytetit temën. Ajo është rruga Shuaib Spahiu, unë qaty banoj, qaty e kam shtëpinë, s'është e jamja rruga. Kështu që mos i ngatërro gjërat. Përndryshe është shumë interesante kur ju vetë keni qenë pjesë e një qeverisje të mëparshme, nuk e preferoj me bë kështu krahasime. Edhe dihet performanca e asaj qeverisje, kurse tash me kuazi argumente imagjinative bën kritika shpesh të paarsyshme. Ngaaniher ja qëllon që është krejtësisht në rregull, por megjithatë demokracia kosovare ta mundëson me fol, me shpreh mendimin tënd, por po ta përkujtoj secili person në mënyrën se qysh e shfrytëzon hapësirën publike, e tregon se sa është konstruktiv edhe sa është i besueshëm. Prandaj të falenderoj për kontributin.

Haziz Hodaj (LDK): Valla Islam përnime talent po më dukesh. Singerishti! Jo nuk e di. Tani jemi tu bisedu për realizimin e buxhetit dhe nuk jemi tu bisedu për votimin. Ti e din që ne, Lidhja Demokratike, asnjëherë nuk kemi qenë bllokues, ne i kemi vou edhe buxhetet e Mytaher Haskukës, sepse nuk kemi dashtë me blloku qytetin për realizimin e shumë projekteve. Sepse kemi konsideruar vazhdimisht që buxhetet nuk janë pronë e pushteti as e qeverisjes, por janë pronë e qytetarëve të Prizrenit. Pra nesër nëse vjen buxheti, ne prap do ta votonim dhe nuk do ta bllokonim. Kështu që jemi shumë të lumtur për atë që e kemi votu buxhetin, mirëpo kjo nuk do të thotë që ne nuk japim vërejtje për mos realizimin e këtij buxheti apo buxheteve tjera. Faleminderit.

Florent Ukaj (LDK): Faleminderit kryesuese. Tash këtu pak drejtori me kryetarin ranë kundërshtim njëri me tjetrin se kryetari tha se me një aneks kontrate kemi larguar disa pozicione ku i kemi pa të dyshimta, sa munda me vërejte, aludove në karrikat, ndërsa drejtori po thotë që kemi me vazhduar me atë kontratë..Po, ç'atë 1700 që na e keni hequr ç'atë karriqe 1700 euro e keni lënë? Veç koordinohu me kryetarin se s'po jeni, më duket koordinuar kohët e fundit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. A ka dikush tjetër edhe të kësaj pike me shtuar diçka? Në qoftë jo, nuk e di qysh jeni me pjesën e agjërimit apo doni me vazhduar apo doni pauzë? Qysh jeni shumica?Ok, në rregull. A po doni me vazhdu? Ok. Po e shoh që shumica ma miratun, ju faleminderit.

Pika e Shtatë

Raporti i komisionit për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësi të tjera për analizim të dëmit të shkaktuar nga fishek zjarret në fund vit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Pra është kjo pikë. Pra kjo është pikë që jemi dakorduar me përfaqësues të partive politike në seancën e kaluar për ta sjellur këtu në komision. Por para se me ja kaloj fjalën komisioni drejtoresha e kërkoi fjalën. Drejtoreshë të lutem, pastaj do t'ja japim edhe anëtarit të komisionit.

Ramize Shala (Drejtiroreshë e Emergjencave): Faleminderit kryesuese, i nderuar kryetar, të nderuar drejtor, të nderuar asambleës, të nderuar qytetarë. Ë, po e ndjej obligim t'i tregoj qytetarëve se mbledhjen e kaluar ju kam treguar dhe juve asambleistëve se komuna e Prizrenit, nuk ka fond emergjent. Jo veç komuna e Prizrenit, po asnjë komunë në nivel të Kosovës nuk ka fond emergjent. Më vjen shumë keq për rastin që ka ndodhur me 31 janar, mirëpo ky rast duhet të trajtohet njëjtë si raste të tjera që hynë në fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera. Andaj, pse thashë po e ndjej obligim me tregu se komuna nuk ka fond emergjent për arsye se barra mos t'i bie komunës së Prizrenit. Unë personalisht e vlerësoj shumë vullnetin tuaj si kuvendar për t'i dal në ndihmë qytetarëve, por besoni që ky rast duhet me u trajtu njëjtë si raste të tjera nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësi të tjera. Për më shumë, është njëri prej anëtarëve të komisionit i cili do t'ju raportojë për raportin çka i është bërë dëmi në atë datë. Ju faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit drejtoresh. Atëherë e thërrasim anëtarin e komisionit, zotërin Fari Krasniqi.

Fari Krasniqi (Zyrtar): Përshëndetje kryesuese, drejtorit dhe ju asambleist të nderuar dhe të gjithë pranishme. Së pari po bëj pak një përfshimje të shkurtër për komisionin. Komisioni për vlerësim i dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë të tjera formohet në bazë të ligjit për vetëseverisje lokale, ligjit për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë të tjera, statutin e komunës së Prizrenit, rregullor për metodologjinë e vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe të tjera, si dhe propozimin e drejtorit të emergjenceve dhe sigurisë. Kurse vendimi për formimin e komisionit nxirret nga kryetari i komunës, i cili gjithashtu cakton edhe anëtarët e tij. Komisioni përbëhet prej pesë anëtarëve dhe ka mandat katër vjeçar. Komisioni ka për detyrë të vlerësojë dhe analizojë gjendjen reale të dëmeve, përpiloj një raport me shkrim për kryetarin e komunës dhe organet kompetente. Gjithashtu për këtë rast tash po raportoj për rastin në fjalë. Ky raport paraqet vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga shpërthimi aksidental i mjeteve piroteknike në Lagjen Bazhdarhone. Raporti është përgatitur nga Komisioni Komunal për vlerësimin e dëmeve dhe duke u bazuar në inspektimet në terren dhe dispozitat ligjore relevante. Bazë ligjore e këtij raporti është ligji për mbrojtjen e nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, rregullore për metodologjinë e vlerësimit të dëmeve, vendimin e kryetarit për formimin e komisionit për vlerësimin të dëmeve. Me 31.12.2024 në lagjen Bazhdarhane ndodhi një shpërtim aksidental i mjeteve piroteknike, i cili shkaktoi dëme materiale në objekte private dhe publike. Fatkeqësisht nga kjo ngjarje ka pasur edhe viktimë, pas raportimeve dhe kërkesave nga qytetarët dhe organet përgjegjëse, komisioni ka dalë në terren, përvlerësimin e situatës dhe dëmeve të shkaktuara. Dëmet të cilat janë identifikuar nga komisioni, janë dëme të konsiderueshme në disa gjama të disa objekteve banesore, janë dëmtuar dy objekte afariste që ndodhen afër vendit të shpërthimit dhe dëmtimet në disa vetura të prakura afër vendit të shpërthimit. Komisioni vlerëson se shpërthimi ka shkaktuar dëme serioze që ndonëse nuk rrezikojnë sigurinë strukturale të objekteve, kanë krijuar probleme ekonomike për pronarët dhe banorët e prekur. Për më tepër humbja e jetës njerëzore e bën këtë rast edhe më alarmant dhe të domosdoshëm për trajtim urgjent. Gjithashtu komisioni rekomandon që të bëhet të hartohet një plan të posaçëm për kontrollimin dhe mbikqyrjen e përdorimit të mjeteve piroteknike duke përfshirë masa rregullative dhe ndërgjegjësuere. Ky raport si përfundim paraqet vlerësimin aktual të situatës dhe ofron

rekomandime konkrete për veprim të mëtejshëm. Komisioni mbetet i gatshëm për bashkëpunim dhe ndërmarrjen e hapave të domosdoshme për menaxhimin e situatës. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zotri Krasniqi. A keni dikush diçka ndonjë pyetje rreth kësaj pike? A ka dikush diçka me marrë fjalën? Po Ilir? Po urdhëro.

Ilir Gashi (LVV): Tash a i bie që nuk kemi me mujt si komunë kurr gjë me ndihmuar të dëmtuarit të veçante janë dy biznese e njëra prej tyre me 66.000 euro dëme është. Herën e kaluar kur kemi seancë u dakorduar që do ta bëjmë një mbështetje. A i bie tash me fjalët e drejtoreshës që nuk ka mbështetje.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Dëgjo, drejtoreshë, veç pak nëse mundem, pikërisht pse nuk mundem me gjetur mënyrën qysh me i mbështetur edhe e kërkuam komisionin për raportim Ilirë. Ne ishim ju e keni pasur përfaqësuesin e juaj, Dafina po më duket ka qenë, Dafina apo? Dafina Alishani. Edhe u dakorduar që me ardhur një anëtar i komisionit ose kryetari i komisionit kushdo qoftë me ardh edhe me raportuar këtu në lidhje me atë punë që e kanë bërë, atë vlerësimin që e kanë bërë. Ndërsa për mënyrën për subvencionime e tha edhe drejtoresha, e tha edhe komisioni se ku kanë mbetur me procedura. Kështu që u dakorduan vetëm me ardhur edhe me raportuar. Po Dafin urdhëro.

Dafina Alishani (LVV): Kryesuese, në seancën e kaluar u diskutua dhe ishin në parim të gjithë të vendimit që duhet të bëhet një mbështetje. Duhet të diskutohet. Kryetar, a ke mundësi me qëndru në këtë pikë se na nevojitesh shumë? Sinqerisht, është një rast tepër specifik. Qe këqyre qasjen çka e ka. A katastrofa ka ndodhur prej paaftësisë këtyre që s'kan qenë gjithmonë? Kryetari i komunës ka përgjegjësi për secilën lagje dhe secilin banor. Po flitet për një rast i cili tragjik, i cili ka ndodhur në natën kur është dashur njerëzit me festu. Ka ndodhur çka ka ndodhur tash po e shohim qysh mundemi me i mbulu këto dëmtime. Edhe këta qytetarë janë qytetarë të Prizrenit bre! Qe edhe drejtori e përcjell kryetarin. A ka dhe ndonjë drejtor që duhet që del edhe që nuk i intereson për lagjen Bazhdarhane. Lironi sallën po mos hajdeni mandej me thënë po bëjmë politikë. Arsyeja pse është diskutuar në këtë pse është thirrur në këtë seancë është me i pas gjithë drejtorat relevantë edhe me shikuar mënyrën se si mund t'i ndihmojmë këtyre banorëve. Pra, del drejtori i urbanizmit thotë lagjen komplet ku ka meremetime e bëjmë ne, ose drejtori i shërbimeve publike. Del dikush tjetër thotë, kaq buxhet ka ose zyra kryetarit çfarë buxheti ka direkte për këto fatkeqësi. Drejtoresha na e dha informatën çka ka drejtorja për emergjenca. A ka vullnet kjo qeverisje me i ndihmu këtyre banorëve, apo ka vullnet vetëm me i sillë këta banorët si një top i ping pongut, prej kërkesës në kërkesë, prej ankesës në ankesë edhe mos me pas kurrfarë zgjidhje. Fatkeqësia ka ndodhur, një banor ka ndërruar jetë aty. Nuk po dua me hy aty se vaj halli për atë familje. Për për një cop gojë për një bukë e ka ndërruar jetë djali vetë, e tash këto biznese që po mundohen me mbijetu aty çka me bërë? Dëmet janë evidente. Ne nuk kemi kërkuar komisioni me ardhur me na treguar sa është dëmi. Neve banorët na kanë treguar çfarë dëmi kanë. Çka tash? E sollëm në rend dite, e bënë një përmbledhje të raportit edhe çfarë po bëjmë? Më falni banorë të lagjes Bazhdarhane, ne nuk jemi të interesuar me ju gjetur juve zgjidhje, as nuk jemi të interesuar bile me ju dëgjuar edhe lirojmë sallën. Kjo është poshtërsi. Edhe sinqerishti, po më vjen shumë keq çfarë qasje të kësaj qeverisje kanë këta banorë. Po le ta shohim banorët se kush po qeveris me këtë komunë. A bën me e ditë drejtor i financave. A ke hapësirë financiare me na tregu këtu kuvendarëve se ne këtu e kemi bërë

e kemi futur në rend ditë për me pasur mbështetje financiare. Nuk kemi kërkuar ne me u diskutuar vetëm sa ka qenë dëmi. Mosni bre, veç vendosni në pozitë atyre banorëve vetëm edhe veç, veç kqyrni çfarë po bëni. Arsyeja pse nuk është bërë seanca e jashtëzakonshme ka qenë me i pas të gjithë drejtorat këtu edhe me diskutuar a kanë vullnet kjo qeverisje me bë diçka për këta banorë? Nëse ju keni qasje urdhëroni, dilni në mikrofon edhe thoni nuk kemi interesim na me i gjet zgjidhje këtyre banorëve. Po urdhëroni tregojeni. Edhe ju kolegë të dashur në seancën e kaluar, fjalë lavdata dhat, dhat premtime jeni për me i mbështe këta banorë vetëm ta gjejmë mënyrën e duhur të diskutohet me kryetarin, të diskutohet me drejtorët edhe çka tash si përfundim. Po heshtim edhe po vazhdojmë me i shiku si po i lirojnë sallën edhe nuk po i bëjmë zgjidhje. Meqë thatë që është viti zgjedhor, mos harroni që këta banorë kanë me votu prap. Po nuk e kanë këta hallin e votës, këta e kanë hallin e mbijetesës. Se ka aty që janë dëmtuar 60.000 euro. Edhe ne jemi këtu vetëm me diskutu' për transparencë, me diskutuar për projekt strategji për sigurinë e institucioneve arsimore, por nuk jemi në gjendje me i siguru banorët e lagjeve që sot ka ndodhur në Bazhdarhane nesër ndodh dika tjetër. Pse nuk ka inspektime, nuk ka rregulla. Bëjmë qysh kemi qejf, qysh ka qejf kryetari qashtu veprojmë. Është tepër për të ardhur keq nëse këtu e keni sjellë në rend të ditës këtë pikë vetëm si raportim e jo mbështetje financiare. Kërkesa ka qenë e banorëve, të cilën edhe juve ju kanë dërguar, ka qenë mbështetje financiare. Për raportime deri këtu jemi mbushur më. Për projekte, për strategji deri këtu jemi. A ka zgjidhje kjo qeverisje për këta banorë? Pyetje ime është për juve.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zotëri Thaçi fjalën e ka kërkuar.

Islam Thaçi (LVV): Faleminderit kryesuese, meqë pardje isha i ftuar në Komitetin për Politikë dhe Financave edhe materialin e kësaj pike të rendit të ditës e kam marrë me kohë. Në ndërkohë nga parëdije deri deri sot kur po diskutojmë jam munduar sinjerishti të bëj pak a shumë në mendime zgjidhje se si mund t'i ndihmohet këtyre qytetarëve meqënëse qëndrojnë fjalët që i tha Dafina, ne të gjithë në seancën e kaluar jemi zotuar që këtë rast, pavarësisht të fatkeqësive të tjera që kanë ndodhur gjatë vitit të kaluar në komunën tonë, ta trajtojmë pak më ndryshe për shkak ndjeshmërisë dhe humbjes së një jete. Meqë pash' raportin edhe e pash' edhe vullnetin e anëtarëve të tjerë në KPF që vijnë nga subjekte të tjera, do të thotë, edhe e analizova vlerën që nuk është vlerë shumë e madhe që nuk mund t'i bëhet zgjidhje brenda buxhetit. Faktikisht nuk paraqet problem për ta realizuar vetëm se a ka vullnet kryetari. Meqënëse na gjatë vitit të kaluar shpeshherë kem bërë votim për bartje të mjeteve ku s'është mundur të realizohet një projekt ose kanë dalë pengesa të tjera. Kuvendi i ka dalë në ndihmë ekzekutivit me bartjen mjeteve nga një kod me kodin tjetër. Meqënëse këto janë subvencione, është e drejtë ekskluzive e kryetarit edhe vullneti i tij për t'i ë përkrah financërisht familjet e dëmtuara në këtë rast. Ju faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zoti Thaçi. Dikush tjetër në lidhje me këtë pikë? Drejtor, a kemi ndonjë përgjigje? Drejtori i financave.

Sulltan Badalli (Drejtor DEF): Po, faleminderit kryesuese. Drejtoria financave nuk bën ekzekutim pa një bazë që duhet të ketë një vendim, pavarësisht nga vjen, por duhet një vendim lidhur me atë dhe për me u ndarë mjetet edhe me i kqyrë burimet e mjeteve me u siguru. Faleminderit.

Islam Thaçi (LVV): Faleminderit drejtor. Sa për rikujtim të kolegëve kuvendarë, meqënëse dhe në anën KPF, në fakt ju e diskutuat, qeverisja e kaluar për shkak të masave të pandemisë, mos gabofsha. Është mundur që t'i del në ndihmë të gjitha kategorive brenda një viti që pak a shumë kanë qenë të dëmtuar. Nga bizneset e deri te familjet në nevojë, por fatmirësisht me përkrahjen e kuvendit. Edhe këtu mendoj se ne të gjithë jemi të gatshëm të votojmë më së pari këtë raport dhe të kërkojmë me një vendim kryetarit që pastaj të subvencionojë këto familje.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit, po Faruk.

Faruk Tahiri (LVV): Faleminderit kryesuese. Përballë e kemi arkën edhe arka është Sulltan edhe s'ka zgjidhje. Ne jemi këtu për me marrë vendim, ju me e ekzekutu. Na tregoni formën, ne do të votojmë për t'i mbështetur këta banorët e kësaj lagje. Me të vërtetë është një mëkat i madh që tre muaj ende diskutojmë për gjëra formale, ala po ardhur te diçka më e plotë për të dhënë vendim për t'i ndihmuar këtyre qytetarëve. Është e pamundshme mos me pas një bazë ligjore për me i ndihmuar qytetarët që kanë pësuar nga një pakujdesi e këtij rasti që ka ndodhur. Një fatkeqësi mund të themi. Por mos me quaj me shumë. Kemi edhe një rast humbje jete, nuk di sa i keni ndihmuar familjes për atë person. Nuk do me thënë kurrëgjë, kjo ngushëllimi po ose ndihma që mund t'ja bëni financiare komuna e asaj familje, domethënë shumë qëndrimi afër saj në këtë moment fatkeqësie, qëndrimi afër këtyre banorëve të cilët kanë përjetuar fatin e zi në natën e fundit të vitit. Prandaj, ne si kuvend nëse nuk arrijmë t'i ndihmojmë qytetarëve, nuk di pse jemi këtu. Ne po arrijmë me bë gjëra të cilat nuk kanë nevojë për qytetarët, po bëjmë pse kemi interesa të tjera, por nuk arrijmë me i ndihmu qytetarëve të cilët kanë përjetuar një fatkeqësi edhe me e lut Zotin që më mos me ndodh fatkeqësi të tilla. Pra nëse nuk jemi në gjendje me i ndihmuar qytetarëve, pse jemi këtu? Pse qëndrojmë këtu? A është mirë komisioni që është formuar. Unë besoj kur e mora raportin, mendova që kemi ardhur me një përfundim ku mund të marrim një vendim për t'i mbështetur këto qytetarë. Dhe jo për raportim. Komisioni do të duhej të vinte me një vendim përfundimtar, me një propozim për vendim dhe ne ta votojmë këtu. Ku mund të merrem mjetet financiare? Besoj që ekzekutivi do të duhet ta di ket më mirë. Neve na kërkohet me votu, ne jemi të gatshëm me votu. Kaq vullnet duhet për me me bë një zgjidhje. Unë nuk besoj që kaq të mbylltë jemi aspektin ligjor sa që mos të mund me i ndihmuar qytetarëve. Është e pamundshme. Ka hapësira ligjore plot, por nuk ka vullnet për me bë zgjidhje. Unë mendoj kështu.

Florent Ukaj (LDK): Faleminderit. Së pari edhe unë njëherë si anëtar i Kuvendit kërkoj falje jo vetëm këtyre qytetarëve që herën e fundit kanë pasur fatkeqësi, po të gjithë atyre që deri tash kanë pasur çfarëdo fatkeqësi natyrore ose që kanë ndodhur në komunën e Prizrenit. Me të vërtetë edhe komisionit gjithashtu i kërkoj falje se po i qesim në pozitë të palakmuar që t'i formuar komisionet, t'i dalë në terren, t'i bërë raporte, t'i mashtruar qytetarë që t'i u takojnë kaq edhe me shifra madje, t'i ju caktuar shifra nga sa kanë me marrë qytetarët për ato fatkeqësi që po ndodhin dhe në fundi rezultati është zero. Këtu unë e kam folur sa herë për fatkeqësitë që kanë ndodhur në rajonin e Përdrinisë sidomos dhe rajonet e tjera në bujqësi. Drejtoresha sa herë na ka thënë këtu që nuk ka mundësi nuk na lejon qeveria. Kam qejf edhe njëherë me dëgjuar drejtoreshën që a kemi të drejtë ne si asamble, me marrë një vendim që me i subvencionuar këto kategori që po që po kanë fatkeqësi të ndryshme. Nëse jo, a mundesh me dal me na na thënë ku është me AME, na ke spjeguar herën e fundit, ku është si procedurë? Se tash po folim që edhe komuna këtu pa dashur me ja bërë

avokatin, por duhet... di që edhe qeveria i ka, nuk e ka vullnetin e duhur, ne se kemi veç komunën e Prizrenit. E kemi komunën e Dragashit, që është shkatërruar totalisht, ku kryeministri ka dalë, ka thënë që shumë shpejt ka me u subvencionuar ose kanë me u dalë në ndihmë dhe hala asnjë, unë i kam informatat e sakta atje, hala asnjë ndihmë financiare nuk kanë ndarë, por as për komunën e Dragashit, as për zonën e Përdrinisë për bujqësinë, por ne tash pe kalojmë ato, hajde po i i tejkalojmë diqysh. Qëtu ku jemi sot. Sa mujtem me parë në KPF nuk ishte edhe shumë më aq e madhe që s'mund në komuna. A kemi ndonjë mundësi ligjore që ne si kuvend duhet me e votuar dhe me i dalë se po i shohim se çdo herë janë në seancë, këta, këta prej një halli janë t'u ardhur këtu. Nuk janë t'u ardhur me na dëgjuar që thotë Dafina për transparencë. Po prej halli të vetë. Prandaj nëse kemi mos lujmë hajgare me ndjenjat e njerëzve se kanë pësuar edhe fatkeqësi edhe dëme financiare edhe krejt. Nëse kemi ndonjë mundësi ta bëjmë edhe të vazhdojmë përpara ti ndihmojmë. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit Florent. Leventi fjalë, po hajde drejtoreshë mandej edhe Leventi.

Ramize Shala (Drejtoreshë e Emergjencave): Po Florent, pikërisht për ato që unë nuk kam dashur me i dhënë shpresë qytetarëve gjithmonë e kam thënë ato që komuna nuk ka fond emergjent. Të jemi të qartë, e kam sqaruar disa herë në çdo mbledhje që ma keni bërë këtë pyetje. Komisioni për vlerësimin e dëmeve është bërë me kërkesë të agjencionit për menaxhimin emergjent. Në vitin 2022 na e kanë dërguar e-mailin se çdo komunë duhet me pas një komision prej disa drejtorive në mënyrë që kur të ndodhin fatkeqësitë natyrore ky komision me bërë vlerësimin e dëmit. Ky komision nuk ka të drejtë me dalë me një vendim ose me një rekomandim qysh ju e kërkuat. Këta kanë të drejtë vetëm me bërë vlerësimin e dëmit.për formën, se si ka me u bë vlerësimi është dhënë formulari prej AME-së. Ju kam treguar edhe në vitin 2022-2023 të gjitha dëmet që janë bë nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë të tjera, e kemi dërguar raportin në AME, është miratuar raporti, është pranuar se edhe atje është një komision mbi këtë komision i cili e kontrollon edhe njëherë dokumentacionin, pavarësisht që është pranuar si raport, nuk është nuk janë mbështetur qytetarët. Edhe më vjen keq jo që nuk kam përgjigje tjetër për ju. Po që kjo është ajo të cilën unë duhet me thënë edhe që kjo është ajo pse unë nuk i kam dhënë shpresë qytetarëve. Nuk e di se cila është forma ligjore që komuna mundet me ndihmuar. Mirëpo edhe unë po dua qytetarët me trajtu të barabartë. Se kjo po hyn në fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë të tjera. Kurse sa i përket komisionit ju kisha lutur t'i dini kompetencat e komisionit. Këta vetëm përpilojnë raporte. Mirëpo nuk kanë të drejtë me ardhur me një konkluzion ose me një vendim se çka duhet me bërë për mëturje. Faleminderit.

Florent Ukaj (LDK): Faleminderit. A mundjmë me ditë drejtoresh, pse komuna jonë nuk ka fond emergjenc? Ku e di ku jemi duke e parë që çdo vit po kemi kemi fatkeqësi të ndryshme.

Ramize Shala (Drejtoreshë e Emergjencave): Unë ju kam tregu, që vitin 2024 kemi pasur takim me të gjithë drejtorët e emergjencave. Ka qenë edhe kryetar i asociacionit të komunave në takim me AME-në. Ne të gjithë drejtorët kemi kërku të paktën një 100.000 eurosh me pas. Nuk po lejohet. Kemi dhënë rekomandime kryetarit të asociacionit që me e ngritur si çështje, që të paktën me na lejuar një fond emergjent, nuk po lejohet.Kështu që për atë punë përderisa nuk kemi ne fond emergjent jemi të detyruar me krijuar raporte me i dërgu AME-ja me dërgu në qeveri, qeveria me

bë mbështetjen financiare. Besoni që kjo që po e them unë është ligjore edhe që kjo është veç ajo rruga për të cilën ne mundemi me bë. Tash unë nuk e di cila është forma që komuna vetë mundet me mbështet.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Me radhë do ta marrim fjalën. Me radhë do ta bëjmë një zgjidhje deri në fund. Leventi po se që dy-tre herë po ja përmendi emrin, mandej me radhë të gjithë.

Levent Bus (KDTP): 2:31:10- 2:33.00

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zotëri Bush. Po këtë çështjen e rekomandimin na e diskutuam edhe në seancën e kaluar. Radhën e ka Kastrioti, pastaj Iliri.

Kastriot Krasniqi (I pavarur): Faleminderit kryesuese. Përshëndetje të nderuar kolegë kuvendar, drejtor, media. Drejtoreshë desha me u ndërlidhë me çështjen e emergjencës rasteve emergjence, si në rastin e Bazhdarhanës. A keni mundësi si drejtor si ekzekutiv, të merret një vendim qysh e kemi marrë në çështjen e pandemisë, ku i kemi ndihmuar qytetarë, kemi ndihmuar biznese. Të merret një vendim si në rastin e Skënderajit, mos gabofsha me 10.000 euro e kemi ndihmuar. Është e thjeshtë, nuk se di pse e komplikojnë kaq shumë. Është e drejtë e kryetarit, e bjer në kuvend. Kuvendi merr vendim, prapë përgjegjësinë nuk ka nevojë kryetari me marrë as drejtori. Përgjegjësia është vetëm ju ndani mjetet, mjetet vijnë në kuvend. Unë s'e di pse e dyta seanca ose debatohet për me ndihmuar njerëz se ju kanë ndodhur fatkeqësia, ajo dihet publikisht. Ata nuk kanë bërë kërkesë pa nevojë. Diskutoni në bord, kini parabord, diskutoni me jurista. Shumë e thjeshtë. Pse i qitni kuvendarët në lajthitje? Çka kanë me u marrë kuvendarët me këtë çështje derisa është mundësia kryetari, drejtorët, gjeni një zgjidhje, bëni në kuvend, kuvendi e shtynë përpara, edhe i subvencioni, subvenciononi ata kategori të cilëve ju kanë ndodhur fatkeqësia. Unë besoj se nuk ka nevojë edhe koleg kuvendarë, besoj se janë pajtimi në këtë formë, as njëri nuk të thotë se jo për mi përkras. Po formën më së mirë ju me gjetur qysh me ardhur deri te subvencionimi i atyre se ju ka ndodhur fatkeqësia, me prurë në kuvend, kalon në kuvend, nuk ka nevojë, nuk po e shoh ndonjë debat se duhet me bë, është e dyta seancë, të njëjtin debat e bëni. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit Kastriot. Fjalën e ka Ilir Gashi, pastaj Adrit Krasniqi.

Ilir Gashi (LVV): Edhe unë e kam këtë propozim të njëjtë pra me kolegët paraprakë Kastriotin dhe Leventin. Do të thotë merret forma qysh kemi bërë herave të kalume, komisioni dhe drejtoresha kanë bërë një punë jashtëzakonisht shumë të mirë profesionale. E kemi tash raportin, e dimë se janë dëmet, nuk është ndonjë dëm shumë i madh në krahasim me suficitin që çdo vjet mjetet na kthehen në nivel qendror. Besoj që është mundësia dhe vetëm ta gjejmë formën qysh kemi vepruar herën e kaluar edhe këtë herë të dalim në mbështetje atyre familjeve të dëmtuara. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit Ilir, po Adriti fjalën pastaj Shukri Quni.

Adrit Krasniqi (PDK): Faleminderit kryesuese. Këtu na u dhanë dy variante për me me i ndihmuar këtyre personave. Një variant nga drejtoresha e cili i shpjegojë procedurat, se si arrin kjo, ky propozim deri në qeveri, të cilën munden këta kolegët këto nga Lëvizja Vetëvendosje me intervenu në qeverinë e tyre, për mos me ardhur këtu e me bërtit edhe me na tregu që kryetari Totaj qeveria e PDK-së është kundër ndihmës këtyne. Po që që këtu jemi ne me vendosur çka po bën

qeveria lokale. Kolege unë nuk jam për me marrë vendim, unë jam për me dhënë propozim sikur ti. Po jam kur sikur ti. Ti po bën politikë. Ti po bën politikë se e akuzove njerin që s'është në gjendje me i ndihmuar qytetarëve. Pse s'është në gjendje? Ku është? E pse nuk i kanë Kryeministri është kryeministri i krejt qytetarëve. Edhe ai pse s'i ka ndihmuar qytetarëve? Jo që tash s'ka qeveri. Që tash s'ka qeveri. Rastin e Dragashit, rastin e Përdrinisë. Pse s'i ka ndihmuar pra?

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Adrit, a ke ndonjë propozim konkret të lutem?

Adrit Krasniqi (PDK): Propozimi konkret është si i kolegëve Leventit edhe Kastrit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Në rregull, shumë faleminderit. Faleminderit. Shukri Çuni fjalën e ka?

Shukri Quni (Nisma): Faleminderit kryesuese. Ne vetëm jemi ka zgjatim debatin, në mbledhjen e kaluar edhe si shefa të grupeve, kemi qenë pajtimit të gjithë sa i përket kuvendit që do ta përkrahim. Mua më nxiti parafolësi pak më herëtq ë tha që, kuvendi domethënë nuk është stabil për me votu. Nuk ka këtu kuvendar që nuk e voton këtë kërkesë. Andaj, sidoqë të vepron drejtoria dhe kryetari, që ky kuvend e voton. Na bini këtu ne e votojmë këtë. Ne kuvendi jemi i pastër këtu. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zoti Quni, Petrit Hoxha fjalën.

Petrit Hoxhaj (Guxo): Faleminderit kryesuese. Mendoj që të gjithë kolegët kuvendarë janë unanim për këtë çështje dhe ka prej këtyre që shumë dhanë edhe propozime. Mirëpo, unë mendoj që ne si kuvend dhe Leventi e ceki që ne si kuvend do t'ia japim vendimin kryetarit për pagesën e këtyre. Duke parë parasysh në faqen e komunës shohim shumë vendime të kryetarit i cili merr për pagesa të ndryshme qoftë të subvencioneve dhe formave të ndryshme, siç është rasti pagesa e rrymës për ish objektin e mbrojtjes popullore është vendim i kryetarit. Ka marrë vendim për pagesë. Vendim për për mbështetje financiare Erblin Eleskurtaj është vendim i kryetarit. Kemi pagesën e mbushjeve telefonike për zyrtarët është vendim i kryetarit. Kemi vendimin e kryetarit për udhëtimin e zyrtarëve në Serbi, është vendim i kryetarit. Thjesht duhet vullnet, duhet vullnet sepse ka forma të ndryshme për këto. Nëse kryetari ka frikë që ndoshta nesër mbasnesër do të hudhet poshtë ky vendim, atëherë ne ja japim dritën jeshile që ne të gjithë 41 kuvendarët jemi dakord që kryetari e ka të drejtën për herë të parë me marrë një vendim me mbështetjen tonë. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit Petrit. A ka dikush tjetër? Ndërgjo. Këtë pjesën, këtë mënyrën me ia rekomanduar kryetarit ne e kemi diskutuar. Po pikërisht kemi dashur me ardhur me dëgjuar këtu edhe komisionin me qenë procedurat më të shpejta deri ku kanë arritur ose çfarë kanë me bë me ministrinë. Kështu që edhe unë si kryesuese po pajtohem plotësisht me shku me rekomandimin ja bë kryetarit si kuvend edhe kështu në qoftëse po pajtoheni të gjithë e hedhim sot në votim ja bëjmë rekomandimin kryetarit, për subvencionim. Ka njëherë keni drejtë fjalën veç ndonjë replikë kështu. Po Dafina urdhëro. Çka deshte me shtuar?

Dafina Alishani (LVV): Kuvendi ka të drejtë me marrë vendim për subvencionim apo jo? Mbulimin e shpenzimeve të cilat janë shfaqur si raportim. Qysh po mundemi me bë bartjen e mjeteve?

Sulltan Badalli (DEF): Ne për rastet emergjente nuk kemi një vijë buxhetore. Se e tregoj edhe drejtoresha që ka qenë mbulimi i shpenzimit e kompetencë e Ministrisë ose agjencionit që është në kuadër të Ministrisë, qeverisë. Edhe subvencionimi, këtu është subvencionim. Nuk është rasti specifik i rasti i 31 dhjetorit. Këtu subvencionimi është i fermerëve, fushave që janë dëmtuar. Nuk është vetëm një rast. E për ato komuna nuk ka vijë buxhetore. Këto duhet me pasur parasysh që nuk ka vlerë që kryetari i nënshkruar që po thotë Petriti ato ka 500 euro, 700 euro 1000 euro. Këto janë vlera shumë më të mëdhaja janë.

Kastriot Krasniqi (i Pvarur): A ka të drejtë kuvendi me rekomanduar kryetarin?

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po.

Kastriot Krasniqi (i Pvarur): Okej. Do të merret vendim, erekomandon kryetarin. Tani është çështja e kryetarit ajo. Nuk është çështja e jona.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Florent a pate diçka me kështu? A po?

Florent Ukaj (LDK): Nëse shkojmë me rekomandim, duhet për krejt fatkeqësitë çka kanë ndodhur deri tash. Mos t'i him në hak edhe të tjerëve. Për të gjithë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Këto që kanë ndodhur për fund vite e kemi fjalën.

Florent Ukaj (LDK): E ato ato të tjerat që kanë. Nëse ka të drejtë për këto duhet me pasur të drejtë edhe për bujqësi.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Jemi duke diskutuar ju lutem për këtë pikë.

Florent Ukaj (LDK): Kryesuese keni përgjegjësi veç tani? Ta ta keni me dije.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Ja ju lutem për qëndrohuni për këtë pikë jemi tu fol për dëmet që janë shkaktuara. Jo ju lutem tash mos ta zgjerojmë këtë. Nuk jam kundër po të përqëndrohemi te pika. Shkëlzeni fjalën e ka.

Shkëlzen Kastrati (PDK): Faleminderit shumë. Unë veç desha një pyetje me bë, ndoshta për vërshimet e kemi dëgjuar mëherët. Po sa kam informata edhe gjatë vitit 2024 një shtëpi është djegur në lagjen Bazhdarhane. Edhe sipas qytetarit edhe ai ka bërë kërkesë nëse mundet komuna me mbështetur. A futet edhe kjo kërkesë në këtë apo?

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Atëherë nëse i ka kryer ai procedurat i ka bërë kërkesa, unë ju kisha thënë, ju lutem përqëndrojeni te kjo. Ju lutem, këtu jemi tu bë fjalë për bizneset që janë dëmtuar në fundvit edhe për familjen i cili e ka humbur anëtarin e familjes. Kështu që mos ta komplikoj më shumë këtë pikë. Po drejtoresh.

Ramize Shala (Drejtoreshë e Emergjencave): Faleminderit kryesuese. Ëh, nëse e bëni ju këtë, ky është rast selektiv. A nëse kërkon me i ndihmu qytetarëve, atëherë duhet të gjithëve. Gjë që është e pamundur. Ky është rast selektiv. E kuptoj që është më i ndjeshëm. Çfarë kishit bërë jo, po

e marrim një shembull. Nëse kishte ndodhur një fatkeqësi natyrore, vërshime edhe kishte mbyttë njerëz. Domethënë është rast, ju po selektoni si rast. Unë po ju them shumë qartë që ky rast hyn në fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë të tjera. Dhe fatkeqësitë të tjera.

Dafina Alishani (LVV): Më fal veç pak, qysh fatkeqësitë natyrore me fishek zjarr me kall një mahall. Qysh është fatkeqësi natyrore? A erdh Zoti me gjujt me fishek zjarre a? Është papërgjegjësia direkte e komunës së Prizrenit. Ju lutem ta pranojmë këtë papërgjegjësi. Është fatkeqësi përshkak që nuk ka pas kujdes inspektorati, e ke pasur aty vend shitje si një kasarnë ushtarake ka qenë. Nuk ka qenë as treg i vogël. Pse? Sepse nuk kanë dalë inspektorat. Nuk është fatkeqësi natyrore. Dhashtë Zoti që s'kena me pasur fatkeqësi natyrore, po jo qysh kështu me i barazu. Unë e kam thënë edhe për Florentin. Florent bjere rekomandimin për fatkeqësitë që kanë ndodhur në bujqësi dhe blegtori, ta votojmë t'i bëjmë presion ekzekutivit. Nuk është e drejtë kështu me liruar salla ose mos me dëgjuar hallin e qytetarëve, qoftë blegtorëve, qoftë kujdo këtu që ka probleme edhe me thënë nuk kemi mundësi. Nëse kemi mundësi me paguar 1700 euro ulëse, kemi mundësi edhe me i gjetur hallin e qytetarëve me i gjetur zgjidhje. Ju lutem mos i shtremboni temat. Nuk është fatkeqësi natyrore.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po anëtar i komisionit?

Fari Krasniqi (Zyrtar): Dafina apo? Ju e cekët se nuk është fatkeqësi natyrore, por ligji për fatkeqësitë natyrore dhe faktikisht të tjera e trajtojnë edhe këtë rast. Kështu që ky trajtohet njësoj sikur raste të tjera që ndodhin prej fatkeqësive natyrore. Baz ligjit dhe metodologjisë së vlerësimit. Po.

Dafina Alishani (LVV): Sipas ligjit a lejohet me u shit fishek zjarrë? Edhe sipas ligjit a lejohet me u mbuluar komplet trotuari me tezga mobile? A lejohet me ligj?

Fari Krasniqi (Zyrtar): Nuk jam unë kompetent. Unë jam kompetent për....

Dafina Alishani (LVV): Ligji nuk e lejon me bë shitjen aty. Pastaj ka pasur rekomandim nga ky kuvend me u bë ndalja e shitjes së fishek zjarrëve. Të lutem, aty ku ke ti hapësirë për profesionizmin tënd, po. Po të lutna se ne kemi probleme, qysh me thënë, kanë qenë të, me anashkalimin e inspektoriatit jemi ku jemi. Po fatkeqësia ka ndodhur. Raporti juaj neve na ndihmon sa është dëmi. Po nëse vazhdojmë me u referu në ligje, ka shumë probleme që nuk është marrë parasysh ligji e që ka ardhur puna deri në humbje të një jetës. Fatkeqësisht sepse nuk është respektuar ligji.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Dëgjoni, nëse pajtoheni unë i kisha dhënë fund këtyne diskutimeve se edhe humbja e jetës u përmend disa herë që nuk po më duket hiç në rregull. Zot i Hodaj s'e ka marrë fjalën hiç edhe po e shoh pajtimin e shumicës, do ta merrni fjalën, pajtimin e shumicës që me shkuar me atë rekomandim kryetarit edhe s'kemi se çka bëjmë. Po zotëri Hodaj uron.

Haziz Hodaj (LDK): Pikërisht, deshta për me përmbyll. Ne si kuvend mundemi me marrë vendim sot, jo vendim por me dhënë rekomandim kryetarit, me pa cila është mundësia e mbështetjes këtij rasti dhe rasteve të tjera. Le të kontaktoj me zyrët ligjore, me interpretues ligjore e tjerë e tjerë dhe të dalë me një vendim. Miratimin e kuvendit e ka. Domethënë, nuk kemi nevojë me e diskutu dhe

me në fatkeqësinë e tjerëve me bë kaq shumë fjalë, kaq shumë debat kur jemi të gjithë pro për sa kemi mundësi me i ndihmu. Natyrisht brenda brenda ligjit.Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit. Po i shoh disa anëtarë që po e ngrisin dorën për herë të tretë, të katërt ju kisha kërkuar mirëkuptim edhe po e qes rekomandimin në votim. Po të lutem.

Ilir Gashi (LVV): I nderuar anëtar i komisionit, drejtoresh, keni bërë punë perfekte, e keni bërë raportin, tash është puna e e kuvendit me marrë vendim. Do të thotë ju e keni bërë vlerësimin, është shumë në rregull edhe jemi falenderues për punën që e keni kryer. Po për kolegët kuvendar. Ky rast nuk krahasohet me raste të tjera, sepse krye këputë është faji i kryetarit të komunës edhe i drejtorisë së inspektorateve, që edhe përkundër vërejtjeve, paralajmërimeve që unë personalisht ju a kam bërë edhe në kuvend, edhe me rrjete sociale, nuk kanë marrë veprime. Sikur zjarri të ndodhte për shkak të fajit të vetë pronarëve të lokaleve, ose për ndonjë arsye tjetër brenda qysh ndodh, qysh është kall shtëpia e kolegës tonë, qysh është kall podrumi i banesës unë ku jetoj ka shkaktuar dëme, atëherë nuk kishte me qenë e drejtë me kërkuar dëmshpërblim, sepse komuna Prizenit nuk është kompani e sigurimeve që dëmshpërblen. Po këtu ka ndodhur dëmi jo me fajin e tyre, po me fajin e komunës që nuk e ka bërë detyrën për të cilën është e obliguar me kryer punën edhe tash ne për me la sadopak fajin tonë, realisht jo fajin tonë por fajin e kryetarit të komunës edhe të drejtorit të inspektorateve, ne në këtë rast duhet të dalim në krah me qytetarët edhe t'i mbështesim financiarisht ose përndryshe dy kompani, dy biznese familjare do të falimentojnë edhe si faj i mos punës së kryetarit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit, faleminderit.shumë shkurt, meqë e morën edhe të tjerë disa herë Florent të lutem sa më shkurt.

Florent Ukaj (LDK): Dafin, ne këtu e kemi pru që tha, të kam thënë me pru rekomandim. Ne e kemi votuar këtu edhe raportin e komisionit, edhe vlerën edhe krejt edhe hala nuk ka ndërmarrë diçka. Edhe diçka tjetër kryesuese. Tash ne pa dashur me ju hy, veç ne këtu kemi me kompenzuar vetura. Nëse e krahasojmë ndoshta një veturë, me një hektar dredhëza ose me një hektar specat që ju ka djeg dikujt atij që e mban familje, atëherë vazhdoni me këtë çasjen që e keni.

Kastriot Krasniqi (i pavarur): Faleminderit kryesuese. Drejtoresh, se më herët e përmende rekomandim, po i anashkaloni të tjerët. Ti nuk i ke prur për të gjitha rastet emergjence. Është rasti i konkret i fundit. Ne jemi duke dashur rekomandimin vetëm për rast të fundit. Ne nuk kemi nevojë me i anashkaluar të tjerit. I biesh në seanca të tjera, qysh e keni pru këto, i bini e të tjerat. Po janë votuar tash është çështja e kryetarit. Edhe te Iliri deshta me u ndërlidh. Jo jo, deshta me u ndërlidh te te Iliri. Nuk mundet me qenë faj i kryetarit. Për çfarë arsye? A ka desh x personi se ka fatkeqësi në familje se njeri se ka shit qatë? Pse a ka desh me i ndodh ajo fatkeqësi atje? Pse koka kryetari fajtor. Për çfarë arsye kryetari tash fajtor? Unë nuk pe kuptoj Ilirin për çfarë arsye kryetari. Shiko Iliri? Ti je opozitë, po në shumë raste me opozitë se ju jam kanë në çështje me kryetarin. Por nuk mundesh me gjuajtur barrën gjithçka tek kryetari në qetë rast. Dihet, prej mbas lufte prej mbrapa që gjithmonë janë shit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Kastriot të lutem, faleminderit. Me sa e pashë propozimet e shumta që kemi që me shkuar me rekomandim kryetarit edhe ai me shkuar brenda mundësive ligjore me marrë vendim për kompensimin e këtyre dëmeve të shkaktuara në fundvit. Atëherë po e hedh në

votim që me shkuar me rekomandim kuvendi i kryetarit. 26 jemi prezent. A jemi unanimisht? Unanimisht, ju faleminderit shumë.

Pika e Tetë

Raporti i punës së Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2024.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Zotri Islam.

Islam Thaçi (Kryesues i Komitetit): A mund t'ja filloj? Raporti i punës së Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenien Sociale për vitin 2024. Komiteti për Drejtoritë e Shëndetësisë dhe Mirëqenien Sociale është formuar në pajtim të rregullores së Kuvendit 01.011- 19415. Aktivitetet janë zhvilluar duke u bazuar në rregullat rregullore të punës së këtij kuvendi. Fushëveprimi i Komitetit për drejtoritë e Shëndetësisë dhe mirëqenies sociale është komision funksional nga muaji qershor i vitit 2022. Ky komitet në kuadër të fushëveprimit dhe të përgjegjësi i diskuton të gjitha çështjet që lidhen me shëndetësi dhe mirëqenies sociale në komunën tonë dhe bashkëpunon me çdo institucion për të marrë informacione të drejtpërdrejta dhe për të ndikuar ose shqyrtuar shqetësimin që mund të paraqiten. Përbërja e komitetit të DSHM-së, anëtar Islam Thaçi, kuvendiar nga radhat e Lëvizjes Vetëvendosje, Driton Daçi, kuvendiar nga Partia Demokratike e Kosovës, Sejra Avdi, ekspert i jashtëm në fushën e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ajdë Çesko, ekspert i jashtëm nga fusha e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Social, ndërsa mungon anëtar i pesë i propozuar nga kuvendi i komunës. Siç keni parë në raport, po mundohem të shkurtojme meqë se është pika e parafundit. Ky komitet i ka mbajtur gjatë vitit 2024, tri mbledhje edhe po ashtu tri vizita në drejtoritë përkatëse, edhe një pjesëmarrje në tryezë të organizuar nga OSCE-ja. Raporti për kuvend. Monitorimi i jonë është nga janari i vitit 2024 dhe ka qenë relasivisht i kënaqshëm. Ne si komitet jemi munduar të kemi kontakte të mjaftueshme me të dy drejtoritë në monitorimin e punës së tyre gjatë vitit 2024. Fokus të veçantë kemi pasur në këto në këto fusha. Realizimi i buxhetit, projektet apo investimet kapitale të drejtorive, shërbimet, cilësia dhe numri i tyre, subvencionat dhe konkurset të organizuara brenda këtyre drejtorive. Drejtoria Komunale e Shëndetësisë. Drejtoria Komunale e Shëndetësisë për vitin fiskal 2024 ka pasur në dispozicion buxhetin prej 8.314.241 eurosh, i cili ka qenë i dedikuar për kategoritë e pagave, meditive, investimeve kapitale, mallrave, shërbimeve dhe pagesën e komunalive. Buxheti shpenzuar për kategoritë e subvencioneve për kërkesat e drejtuar Drejtorisë Komunale të Shëndetësisë për mbështetje financiare është realizuar nga mjetet e cilat kanë qenë nën menaxhimin e zyrës së kryetarit të komunës. Nga shuma totale e buxhetit të planifikuar nga Drejtoria Komunale e Shëndetësisë i është shpenzuar 8.126.069.80 ose 97,74% e buxhetit në të gjitha kategoritë. Sipas kategorive janë këto vlera të buxhetit. Paga dhe meditive janë 4.568.401.000 mallra shërbime 2.145.841 euro, investime kapitale 1.500.000 euro dhe komunalit vlera 100.000 euro. Nga kategoria e investimeve kapitale në Drejtorinë Komunale të Shëndetësisë ka pasur planifikuar realizimin e projekteve si në poshtë për vitin 2024. Vlen të theksohet se në këtë drejtori janë projektet shumë vjeçare. Furnizimi me autobulanc për qendrën kryesore të mjekësisë familjare, furnizimi me aparat të mamografisë, vazhdimi i ndërtimit të qendrës kryesore të mjekësisë familjare tek KFori, ndërtimi i qendrës së mjekësisë familjare në lagjen Tusuz, blerja e aparaturave jo mjekësore

elektronikë, kamera, gjenerator, teknik, të bardhë e të tjera. Digitalizimi i shërbimeve të analizave laboratorike, furnizimi me aparaturë stomatologjike, furnizimi me aparaturë mjekësore, furnizimi me pajisje për ngrohje qëndrore, klimatizim të objekteve të KPSH-s. Buxheti i planifikuar për realizimin e këtyre projekteve ka kapur vlerën prej 1.500.000 nga ky buxhet janë shpenzuar 1.489.332 euro apo rreth 99,29% e këtyre mjeteve. Gjatë periudhës janar-dhjetor 2024, Drejtoria Komunale e Shëndetësisë përmes njësive shëndetësore dhe stafit i tyre profesional ka ofruar shifrën e rreth 924.274 shërbime shëndetësore. Duke u filluar nga muaji mars e deri në 22 nëntor të vitit 2024 është bërë pranimi i dokumentacionit për mbështetjen financiare për kategori të përcaktuara në rregulloren për ndarjen e subvencioneve. Janë parashtruar 1127 kërkesa, nga ato validë janë 1105, ndërsa janë refuzuar 22. Prej kërkesave të aprovuara 919, kërkesa janë realizuar me pagesë përkatësisht për kërkesat e parashtruara nga muaji mars deri në muajin gusht të vitit 2024. Për 186 kërkesa të tjera të paraqitur gjatë muajit shtator, tetor dhe nëntor, janë marrë vendime nga kryetari për aprovim. Mirëpo për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore të njëjtat kanë mbetur që të realizohen gjatë vitit 2025. Për 919 kërkesa për të cilat është realizuar pagesa, janë shpenzuar 368.000 euro. Gjithashtu është realizuar pagesa 271 për 271 persona, kërkesat të cilat kanë mbetur të pranura në vitin 2023, mirëpo për shkak të mungesës e mjeteve financiare në vitin 2023 janë përcjellur për realizim në vitin 2024. Shuma që është ndarë për këta persona kap vlerën e 108.400 eurove. Në total shuma me të cilën janë mbështetur të gjitha këto kategoritë kap vlerën prej 476.400 euro. Në vitin 2024 në drejtorinë e Shëndetësisë janë mbajtur këto konkurse. Për shërbim publik janë mbajtur dy herë konkurset për doktor të mjekësisë, njëherë për farmacist, infermier të përgjithshëm, doktor stomatolog, doktor specialist i biokemisë, biokemisë klinike, specialist i radiologjisë, teknik i radiologjisë, teknik laboratorant, zyrtar administrativ, zyrtar i depos, zyrtar për buxhet dhe financa, ndërsa për shërbim civil, është mbajtur konkursi përveç të sektorit i Shëndetësisë dhe për zyrtar ligjor. Vlen të theksohet se ne si komitet nuk kemi pranuar as dhe një ankesë për konkurset të zhvilluara në këtë drejtori nga aplikuesit. Drejtoria për punë dhe mirëqënien sociale. Drejtoria për punë dhe mirëqënien sociale përsa i përket projekteve apo investimeve kapitale veçohet me këto projekte. Projekti i ndërtimit i banesave sociale në lagjen Petrov, bëhet fjalë për kullën katër, këtu është vazhdimi i projektit. Këtu kanë vazhduar punimet për përfundimin e këtij objekti punë të cilat janë ndërprerë vite më parë. Vlera e parapavara e këtij projekti është 492.000 euro të realizuara janë deri tani 50.000 euro. Janë vendosur dritare të reja pasi të vjetrat kanë qenë të demoluara dhe puna vazhdon sipas planit dinamik. Renovimi i banesës kolektive në lagjen Petrov, Kulla 3. Këtu punimet kanë filluar gjatë vitit 2024. Vlera e investimeve është 289.916.20 euro, janë realizuar 254.000.30 euro. Ka përfunduar pjesa më e madhe e punës pasi ky projekt është dy vjeçar. Ndërtimi i shtëpisë për të moshuar është vazhdim i projektit. Projekti për rregullimin e infrastrukturës së jashtë ka përfunduar vlera e kontratës ka qenë 94.250 euro, i realizuar 84.521 euro. Ankesa për përfundimin e punimeve, Aneks për përfundimin e punimeve të paparashikuara vlera është 9.220 euro të realizuara 8220 euro. Staf i është rekrutuar në dhjetor dhe janar të vitit 2024, të punësuar nga ajo kohë por pa u funksionalizuar objekti ende. Furnizimi me inventar për shtëpinë e të moshuarve në kohë kur është përpiluar ky raport ka qenë në fazën e procedurës së tenderimit. Vlera e parashikuar për këtë tender është 153.900 euro....Ky komitet i ka mbajtur tri takime dhe tri vizita në drejtorinë. Në qoftë se doni unë shkoj edhe me data edhe me pika të rendit. Janë brenda raportit. Si komitet fatkeqësisht e di që ka pas pakënaqësi

ndoshta për konkurset po realisht që tre vite ne si komitet, asnjë qytetar nuk ka ardhur te na me u drejtuar që është bërë një e padrejtë ndonjë konkurs. Kështu që kjo është sa i përket punës tonë.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zotëri Thaçi, po zotëri Hodaj fjalën e ka.

Haziz Hodaj (LDK): Se i tha Qemali po vërtetë ne nuk po i kuptojmë mirë rolin e komisioneve të kuvendit edhe punën e ekzekutivit. Ju fakt ju faktikisht po jepni raporte të drejtorive përkatëse që do të duhej drejtorit përkatës me dhënë raporte për realizim të buxhetit, për ndërtim, për, për mosrealizime e tjera e tjera, komisioni çfarë, çfarë pune ka me na dhënë neve raport të atillë, komisioni e kontrollon, nëse ka vërejtje në këto, në këto projektet e tyre, në punët e drejtorive përkatëse, na e raporton neve, përndryshe ju mos ipni raportet të drejtorive që drejtorit duhet me dhënë. S'di a jemi, jemi të qartë, se kjo ka nuk është ndodhur veç tash. Ka ndodhur edhe disa herë më përpara. Komisioni duhet me e ditur rolin e vetë edhe duhet me e ditur rolin e të ekzekutivit që e ka. Ju nuk duhet me i ndarë këtu. Komisionet nuk japin raport për punën e drejtorive. Kaq!

Islam Thaçi (Kryesues i Komitetit): Besoj se edhe unë isha i qartë, zotëri Haziz. Jo, tash ne i kemi pasur tri takime. Unë isha t'i raportuar gjetjet po me me gjasë s'më keni dëgjuar me vëmendje. Po i thashë unë, janë shpallur konkurset, kërkush s'është ankuar te ne, unë e lexova në fund. Edhe vërejtja te shtëpia, te shtëpia të moshuarve ke, do të punimet vazhdojnë, para një vite janë punësuar, stafi duhet paga ecën, objekti s'është kërkund i funksionalizuar, s'po e di çfarë vërejtje tash, a kupton? Veç me i marrë me të kuqe me i analizuar. Ju faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faleminderit zoti Thaçi. Dikush tjetër a ka rreth kësaj pike? Nëqoftëse jo, atëherë ju falenderoj edhe anëtarëve të Kuvendit edhe zotin Thaçi. Atëherë po kalojmë Po urdhro, unë jam tu u pyet, a keni dikush fjalën ju në telefon? Urdhro Faruk.

Faruk Tahiri (LVV): Faleminderit kryesuese, i nderuar kolegë kuvendar. E kam një pyetje sa i përket Drejtorisë së Shëndetësisë gjatë këtyre monitorimeve që i ke bërë, a ke vërejtur se gjatë kësaj periudhe kur ka filluar qeverisja Totaj, ka pasur disa lëvizje në aspektin e zbritjes nga detyra e disa drejtorëve, si dhe ka pasur përjashtim nga puna e një doktori që ka punuar mbi 20 vite, 20 vite në QKMF. A ka ndonjë monitorim gjatë kohës kur është marrë një intervistë për përjashtim nga puna e këtij doktori? Si dhe a keni pasur, a keni vërejtur, mungesë të shërbimeve të QKMF-së, qendrave kryesore të mjekësisë familjare dhe qendra mjekësor që nuk janë dhënë deri më tash për qytetarë dhe apo ka pasur vonesa në furnizim në kesi far gjërash.

Islam Thaçi (Kryesues i Komitetit): Sa i përket pyetjes së parë, Faruk, unë e potencova, ne kemi shprehur interesim, mirëpo personat në fjalë, derisa nuk i drejtohen këtij komiteti, ne s'mund të vrapojmë për ta, a kupton në kuptimin, jemi njoftuar me procedurat që janë zhvilluar. Komisioni disiplinor, mirëpo është, çfarë me thënë, ne e kemi ngritur si shqetësim, kemi marrë informacion nga drejtoria, mirëpo tash ne nuk mund të ndërhyjmë në punën e komisionit disiplinor e të tjera. Do të është çështje që, Jo në monitorim jo, mirëpo kemi marrë informacion do të edhe njëri nga ata meqënëse kanë qenë tre katër veta do të i kam dëgjuar. Me gjithë kërkesën time që të na drejtohen me kërkesë me shkrim, njëjtë siç i ceka te te rasti e keni pasur rastin e konkursit para dy viteve mos gaboj do të gjithë palët janë drejtuar gjykatës, neve si komision i këtij kuvendit nuk na është afruar asnjë asnjë qytetar që ka aplikuar. Pyetje e dytë, cila ishte? Mungesë të shërbimeve meqënëse ne kemi marrë edhe raportin mujor, vlen të theksohet se ëmuaj nga muaj do të dallohen

sa i përket numrit të shërbimeve për shkak të gjendjeve të ndryshme epidemiologjike që janë, do të gripisi zona e gripnave të tjera. E veçanta është se ka qenë ndërprerja e shërbimit për një vit apo sa ka qenë të ofrimit të shërbimit që është promovuar në qeverisjen e kaluar, mirëpo ka vazhduar me një vit vonesë përsëri edhe me një riorganizim me sa di unë të stafit edhe si shërbim ka vazhduar. Kohë pas kohë ka pasur mungesë të ofrimit të shërbimeve me të marrë markera e tjera, mirëpo, siç po ndodh në furnizim, ashtu po vazhdohet me atë shërbim. Do të thotë që s'ka ndërprerje me thënë që është ndalur një shërbim nga ajo që është ofruar qytetarit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Qemali, pastaj Iliri. Po zoti Qemali.

Qemal Krasniqi (LDK): I tha parafolësi im. U thanë ato çka dashna me e thënë. Edhe e di që shumë keni punuar ju si komision, kështu që s'po dojmë me ju ngarkuar.

Ilir Gashi (LVV): Koleg, ju thatë që janë punësuar 13 persona për shtëpinë e të moshuarve. Po ajo shtëpi unë sa e di nuk është funksionale. Si komision, a keni informata, përgjigje nga drejtoria përkatëse? Pse ka ardhur deri në këtë gjendje edhe qysh do të veprohet tashmë e tutje? Ose ju si komision, a do të procedoni edhe lëndën, organet hetuese, nëse është bërë një veprim i tillë?

Islam Thaçi (Kryesues i Komitetit): Njëra prej gjetjeve ishte edhe kjo zotëri Gashi se konkursi është zhvilluar para funksionizimit të objektit. Ne këtu kam pas edhe zotime që objekti do të përfundon gjatë fundit të vitit të kaluar, mirëpo e di që shumë drejtorë kaniherë bijnë prej të presionit që u bëhet edhe premtojnë gjëra që realisht nuk janë në dorë të tyre. Mirëpo fatkeqësisht kjo ka ndodhur, do të thotë janë pranuar komplet stafi për shtëpinë e të moshuarve janë 13, mos gabofsha. Janë staf profesional. A kryen ndonjë punë aty tani me pyet drejtorin? Meqënëse ne nuk kemi hyrë në këto detaje, drejtori është këtu. Mund me ju treguar se ku janë sistemuar, pse janë sistemuar, kjo është.

Ertan Simitçi (Ythp): Islam. Sot çdokush kush ka dalë aty në foltore na dha përgjigje kaçamak. Domethënë, po ndodh për shkak i Ramazanit. Po tash unë nuk po e di ti a je aty si drejtor apo si kryetar i komisionit, a e din? Si ish-drejtor apo si drejtor aktual mos ka ndonjë ndryshim ndonjë send. Pyetje nuk ka vetëm sukses.

Faruk Tahiri (LVV): Faleminderit kryesuese. E pata një kërkesë pasi ishim te komiteti. Kemi edhe komitetin për arsim ku jam edhe unë anëtar aty. Kemi qenë në fillim shumë aktiv në këtë komunitet dhe kemi vëzhguar goxha shumë drejtorinë e arsimit, po që një vit e gjysmë na kryesuesen e kemi nga jashtë, nuk është prej asamblesë, edhe e dimë që nuk marrin meditje për mbledhjet që i mban. Nëse dojmë me pasë efikazitet në komitetet, do të ishte mirë që së paku ata që vijnë nga jashtë që nuk janë anëtarë të kuvendit të kenë një meditje që të bëhen puna si duhet dhe kohën që e harxhojnë gjatë këtij komiteti. Unë mendoj që është dashur me trajtuar deri më tash, se që një vit kemi mungesë të funksionimit si duhet të komitetit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Faruk unë e kam një përgjigje me këtë. Jemi kolegji i kryesuesve edhe kam qenë shumë e rregullt në çdo mbledhje atje. Edhe me muaj e me vite e kemi diskutuar këtë, sepse jo vetëm si Prizren e kemi këtë problem. Edhe me Ministrinë përkatëse e kemi diskutuar shumë, po ja që nuk gjithmonë sa herë jemi takuar na kanë thënë që në takimin e radhës do ta keni një përgjigje pozitive. Kështu që mundem me thënë me plot kuptimin e fjalës që

kemi bërë shumë përpjekje në këtë drejtim po nuk kemi arritur ndonjë zgjidhje. Ju falenderoj të gjithëve për kontributin e pikës tetë. O Petriti po hajde Petrit.

Petrit Hoxhaj(Guxo): Kështu, kryetarin e komisionit e kishna pyetur në viteve të kaluar, do të thotë edhe në në mandatin e qeverisjes së kaluar ka pasur shumë donacione prej kompanive dhe Ojq-ve të ndryshme të cilët kanë dhënë ndihma nëpërmjet drejtorisë dhe mirëqenies sociale. Pse këto vitet ka shumë pak që komuna jep donacione për familjet skamnore, edhe nëse jep, e jep me numër të kufizuar. Ku është problemi? A nuk ka bashkëpunim, do të thotë a nuk ka bashkëpunim me donacionet dhe organizatat të tjera humanitare, apo nuk janë të interesuar as komuna me ju ndihmuar familjeve skamnoreve nëpërmjet kësaj drejtorie? Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese): A keni dikush tjetër? Jo, faleminderit zoti Thaçi, lutem mikrofonin. Ju falenderoj të gjithëve për kontributin që e dhatë në pikën e tetë, po kalojmë te pika e nëntë që u bë propozimi i ri sot pra për dhënien e titullit post mortem për zotërin Shaqir Shehu.

Unë e thashë qysh në fillim, me thënë të drejtë rregulloren e re e kam lexuar një herë por nuk isha shumë e qartë sepse doli kjo si pikë ad-hoc kështu. Po e pashë, e dita që nuk jemi shumë në rregull me procedura sepse rregullorja të cilën e kemi miratuar në muajin nëntor po në këtë kuvend thotë që propozimin për ndarjen e dekoratës titullin mund ta bëjnë pra kryetari i komunës, kryesuesi i kuvendit, 1/3 e anëtarëve të kuvendit të komunës edhe 3000 qytetarë të komunës së Prizrenit me të drejtë vote. Pra me e bërë këtë propozim te komisioni, i cili brenda 15 ditëve duhet ta shqyrtojë edhe pastaj e bien listën me propozime në kuvend. Mirëpo meqë hyri në rend ditë, unë edhe në konsultim me zyrtar ligjor, atëherë po e marrim si të mirëqenë si propozim i një tretës anëtarëve të kuvendit, edhe këtë kërkesë menjëherë do ta dorëzoj te komisioni që... Jo, nuk e besoj që ka Unë e thashë që do ta marr edhe do ta dorëzoj te komisioni e mora përsipër kështu. Po, nuk e di më zyrtari ligjor a ka nevojë me këtu diçka? Në rregull. Mandej, domethënë brenda 15 ditë dhe komisioni e shqyrton. Po Kastrioti e ka, zotëri Quni meqë e bëni propozimin?

Shukri Quni (Nisma): Shiko, un e fillimisht dua të t'i falenderoj kolegët se për herë të parë e kam e kam bërë një propozim që sa mandate janë këtu. Edhe këta shumë më kanë mirëkuptuar se është një propozim serioz. Edhe pos i falenderoj që i kanë për krah edhe kemi futur në rend të ditës. Edhe besoj që nuk jetë vetëm në letër, por besoj që do do ta realizoni se Kastrioti tha unë këtë kërkesë e kam bërë tha goxha herët tha, është i njoftuar tha, nejse Kastrioti le të flet edhe vetë. Po unë e pata kërkesë prej organizatës së veteranëve të luftës. Është e përgatitur edhe biografia bile propozova që Shukrija ta lexoj biografinë në rast se doni me, kush është për shembull doktor. Epo mirë atëherë, masi e dini kush është doktor Shaqir Shehu atëher i falenderoj të gjithë edhe ti Kastriot besoj që...

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Po për këtë arsye zoti Quni meqë e pashë unanimitetin po them që po e marrim si të mirëqenë 1/3 e anëtarëve të kuvendit edhe po e bëjmë. po Kastrioti. A sa për biografi në qoftëse doni me e dëgjuar sot, në qoftëse jo..

Kastriot Krasniqi (i pavarur): Faleminderit. Unë vetëm desha me falenderu Shukri Qunin, që e ka marrë iniciativën bashkë me kryetarin e shoqatës, shoqatën e veteranëve të luftës, kështu që besoj se të gjithë koleg kuvendarët e njohin Shaqir Shehun, u kanë kontribues i luftës së Çlirimtare të Kosovës, kontribuesi UÇPMB-së, UÇK-së Maqedoni, pas luftës ka kontribu e ka një kontribut

të jashtëzakonshëm, fatkeqësisht pandemia ja ka marrë jetën e edhe njëherë faleminderit Shukri, faleminderit shoqatës veteranëve të luftës. E kolegëve patjetër se kur falenderoj ty ...

Antigona Bytyqi (Kryesuese): Unë ju ju falenderoj të gjithë anëtarëve të kuvendit për kontributin e kësaj mbledhje, meqë jemi në prag të festës së Bajramit ju uroj të gjithëve Fitër Bajramin. Gjithashtu në muajin prill i kemi edhe pashkët katolike dhe ortodokse të gjithë komunitetit katolik urime. Mirupafshim seancën tjetër.



**Kryesuesja e Kuvendit
Antigona Bytyqi**

Bytyqi